

QAZIM MUSKA

**KRISTOS**

ROMAN

---

BOTIMET TOENA



QAZIM MUSKA

# KRISTOS

roman

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2020

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Diana Çuli

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-327-42-0

© Autori dhe Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

[www.toena.al](http://www.toena.al)

## Pjesa e parë

### 1

Ulërinte, thërriste me tërë fuqinë, qante e lotët i binin rrëke faqeve. Zgjaste duart me stërmundim, me vendosmëri, me ngulm, pa pushim. Dy krahë të fuqishëm e shtrëngonin për beli, nuk e linin të bënte asnjë hap përpara, të mundte ta kalonte atë va gjithë baltë e turbullirë, të vërsulej me rrëmbim, t'i hidhej ndër krahë, ta përqafonte fort, ashtu si nuk kishte përqaftuar kurrë. Nga ana tjetër, pas dallgëve të shkumëta, dikush e tërhiqte gruan pas, si një zbatice e egër. Edhe ajo zgjaste duart drejt tij, ca duar që dridheshin, të holla e të thata, shkarpa. Çehren e kishte të lemerisur. Bërtiste edhe ajo me sa fuqi kishte, sytë i lëshonin shkëndija të egra. Ia merrte një erë e marrë flokët e gjatë e ia shtrinte pas shpinës, e shndërronte në një sfinks të frikshëm. Përreth errësirë, qielli i mbyllur krejt. Veç vetëtimat çanin hapësirën e zezë, bubullimat oshtinin cep më cep me rrapëllimë. Ajo herë shfaqej, herë zhdukej në kufirin mes baltës dhe dallgëve, si nimfë e tërbuar, pa ditur kë të zgjedhë për prehje; dheun apo ujin. Largohej gjithnjë e më shumë, ndërsa fasha e dritës,

e cila binte si projektor në hapësirën mes tyre, sa vinte ngushtohet. Në bel ndiente shtrëngimin e krahëve të fortë si prej çeliku, por dhembjen nuk e përfillte, shqyente sytë në drejtim të gruas që po humbte nëpër ujë e nëpër terr dhe ulërinte si ujk i plagosur.

Sakaq, një vetëtimë u dha rishmi, një zhurmë buçitëse i shurdhoi veshët, një dritë verbuese sulmoi gjithçka. Zgurdullonte sytë e ngulur për matanë bregut, me shpresë të ndodhte mrekullia, të kthehej mbrapsht gjithë ç'ndodhi: zbatica të shndërrohej në baticë dhe ajo grua të shfaqej mu para hundës së tij, jo e lemerisur nga dhimbja, jo e patakur nga ikja, jo e drithëruar nga ndarja, por e paqte si një pëllumb, me sytë plot gëzim e hare, pa ata lot që i binin rrëke faqeve, me zemrën e mbushur me dashuri. E, pastaj...

Pastaj drita e vetëtimës u fashit sa hap e mbyll sytë. Jehona e krismës u shua. Një njollë e stërmadhe katana dhe e errët katran filloi binte nga lart në trajtën e një zogu gjigant. Zmadhohej e zmadhohej sa më shumë ulej poshtë, derisa e gllabëroi brenda vetes. Ankthi e pushtoi të gjithin. Zemra gati po i pushonte, kraharori po i çahet ngaqë as merrte, as nxirrte frymë. Tëmthat i godisnin fort. “Patjetër fundi”, i foli vetes i tmerruar nga mendimi i tij. Befas, ndieu në faqe një butësi mëndafshi, një ledhatim të ngrohtë mbi kokë, një zë që i pëshpëriste fare pranë dashurisht, si frymë perëndie në një miklim ringjalljeje.

- *Pedhi mu, pedhi mu!*, qetësohu! Jam unë këtu! Jemi bashkë, *pedhi mu!*

---

<sup>1</sup> Gr. – Biri im

Zëri sikur vinte nga një tjetër botë. Kishte frikë t'i hapte sytë e të shihte. Nanurisja vazhdonte e pandërprerë rrëzë veshit, me po atë dhemshuri dhe miklim të shenjturuar. Me një regëtimë shprese dhe me makthin e topitur disi, hapi ngadalë sytë. Pastaj i shqeu fort prej habisë, si të kishte përpara vetë Perëndinë. U ngazëllye aq shumë sa po i gufonte kraharori, lotët iu rrëzuan sërish faqeve, fytyra iu çel si agim i pranvertë. Shihte dy sy plot mirësi, të cilëve nuk mundi t'u rezistojë: lëshoi kokën në prehrin e njeriut që e pati nxjerrë nga skëterra dhe u shkreh në ngashërim të thellë. Veçse, përbrenda ishte mbushur me shpresë dhe siguri si prej Zotit.

Ngashërimi iu tulat pas disa minutash, ndërsa dora e butë si mëndafsh vazhdonte t'i ledhatonte kokën, shpinën, supet e njomë, qafën e hollë, me fërkime të lehta damarëve, në formë masazhi. Ndërsa, pranë veshit dëgjonte pëshpërima të dhembshura.

Nuk guxonte ta ngrinte kokën nga ai prehër. Frikej mos e gjithë kjo mrekulli përmysej brenda sekondës. Rrinte pa lëvizur, duke mbajtur frymën, derisa dy duar e kapën për supesh lehtë, për ta nxjerrë nga ajo molisje. Papu Kosta e largoi në të djathtë mjekrën e zbardhur fije-fije dhe ia mbështeti kokën në kraharorin e gjerë. Ia fshiu lotët me shaminë e bardhë që e nxori nga xhepi i ramos, e përkëdheli në faqet njomëzake, e puthi në ballin e djersitur prej sikletit dhe e pyeti me zë të ulët, të qetë, ashtu siç ftonte mëkatarët në rrëfim:

- Ç'ndodhi, biri im, ç'të ngjau?

Ai heshtte. Nuk dinte nga t'ia niste. Ende i buçitnin veshët nga klithmat, nga bubullimat. Sytë i mbante

mbyllur, sikur drita e vetëtimës do t'i ngulej mu në ninëz, tëmthat ende i rrihnin me furi dhe koka i rëndonte si të qe prej guri. Por, ngrohtësia e trupit të priftit e ndillte në paqe, shtrëngimi në kraharor dhe përkëdhelja e shpinës si një kotele i afronte prehje, zëri i tij i butë i rikthente qetësinë.

Jashtë vazhdonte të binte shi i rrëmbyer. Ende ishte si në jerm, nuk arrinte të kuptonte qartë në ishte ky çast vazhdim i asaj që sapo kaloi, apo një realitet i ri, pa lidhje me të parin. Fryma e njeriut të perëndisë, që dilte prej flegrave të hundës dhe i ngrohte qafën, sikur e shkundi. E pa në sy, në ata sytë e vegjël, futur thellë strehëve të dhjamosura nën vetullat e trasha, të cilët e zhbironin me këmbëngulje. Duhej të thoshte diçka, të fliste, të dilte nga ajo topitje. Duhej të rrëfente. Edhe vetë e ndiente se duhej të rrëfente, ta nxirrte jashtë atë ngarkesë ankthi, atë lemeri të ngërthyer në gjoks, të çlirohej si prej disa kulprave të mistershme. Po s'dinte nga të fillonte. Atëherë, prifti e solli nga vetja dhe i pëshpëriti ëmbël e ëmbël si ndonjë foshnje:

- Pa më rrëfe pak, ç'ndodhi, *pedhi mu*?

E vështronte ngultas, me vështrim mallëngjyes e gjithë padurim. E shikonte edhe ai priftin me sytë e lagësht nga lotët, por me një dritë të ringjallur, me besim dhe shpresë të re. Dhe nisi të fliste. Buzët i dridheshin, fjalët mezi i radhiste, ca prej gjendjes së vet të sikletshme, ca prej gjuhës së huaj. I përziante fjalët e të dy gjuhëve, i bënte lëmsh. Prifti dëgjonte qetësisht përçartjet e tij. Pastaj, i ledhatoi faqet, po sikur një foshnje dhe i tha:

- Qetësohu, bir, qetësohu!



Djali i ndaloi belbëzimet çapraz. Mori frymë thellë dhe foli me mundim të madh.

- Ishte nëna!

Priftit iu bashkuan vetullat e trasha në mes të ballit. Picërroi sytë, hoqi duart nga supet e djalit, e vështroi ngultas, tha me habi:

- Nëna?! Oh, biri im, me siguri do të kesh parë ëndërr!

Djali, vari kokën mbi gjoks, shihte dyshtemenë. Me zë të mekur iu përgjigj priftit, i cili nuk ia ndante vështtrimin ngulmues.

- Nuk e di, ndoshta ishte dhe ëndërr. Unë nuk kam parë kurrë ëndrra, por nënën e kam menduar shpesh. Dhe sot e pashë.

Prifti mendoi se djali ishte ende si në kllapi, fliste përçart. Iu dhimbs, ndaj nuk foli menjëherë. E la të qetësohej, të mbushej mirë me frymë.

- Është fanepsje, biri im! - i tha pas pak. - Të ikurit na shfaqen shpesh në forma të ndryshme, por Zoti i ka ndarë punët; ata lart dhe ne këtu, në tokë. Dëshira për t'i pasur pranë na bën të shohim shëmbëlltyrat e tyre dhe të trazohemi. Malli për të dashurit e ikur përherë është brengosës.

- Nuk mund të ketë vdekur! - gati thirri djali.

Fytyra iu lemeris përsëri. Lemerisë në fytyrën e tij iu përgjigj habia në atë të priftit. Shqeu sytë sa mundi ngaqë nuk po u besonte veshëve. Mendoi se diçka e rëndë do t'i kishte ngjarë përderisa përjetonte të tillë shpërqendrim, të tillë hutim dhe të tillë lajthitje. “Ç’djaj ta paskan helmuar shpirtin, o rob i perëndisë, - mendoi papu Kosta.

- Ç' demonë të paskan sulmuar?" Iu qas më pranë dhe ia mbështeti përsëri kokën në sup. I foli si një fëmije kur duam ta zgjojmë nga gjumi pa e bezdisur.

- Hajt, tani, mblidhe veten! Hiqi yshtjet nga mendja dhe lutju Perëndisë të të mbrojë nga demonët. Do të qetësohesh dhe do të harrosh vegimet e liga. Edhe shpirti i nënës tënde do të prehet në paqe kur të të shohë të qetuar. Shtriu dhe mundohu të flesh!

Prifti mori batanijen t'ia hidhte sipër, po vërejtë se ai nuk po lëvizte. Buza filloi t'i dridhej, fytyra sërish i mori pamje melankoliku, ndërsa nisi të belbëzojë:

- Nuk e kisha parë kurrë, papu, kurrë! Sot qe hera e parë. Më thërriste në emër. Dhe qante. Pastaj, e rrëmbyen, nuk e di kush. Stuhia a ndonjë hije e rrëmbeu mes dallgësh e territ. Nuk e kisha parë kurrë, papu!

Fliste me mallëngjim të thellë, shikonte nga dritarja natën e zezë që oshtinte nga zhurma e shiut. Kostë Kondit iu bashkuan sërish vetullat mbi hundë dhe sytë iu picërruan brenda zgavrave të dhjamosura nën to. I lëvizi muskuli i syrit, cepi i tij u drodh disa herë.

- Dil nga kjo ëndërr e mallkuar, biri im! - i foli me ton urdhërues! - Po flet përçart! Le të prehen në paqe prindërit e tu! Shpirtrat e tyre janë nën hir të Perëndisë tani. Lutu për ta dhe qetësohu! Të vdekurit me të vdekurit, të gjallët me të gjallët; kështu është dhënë nga Zoti.

Djali u step, ngriu si të ishte prej mermeri. Një si pendesë ia rrëmbushi sytë. Shikonte priftin sikur t'i përgjerohej për faljen e ndonjë mëkati. "Ç'dreqin ka pësuar që ndryshon si kameleon çdo çast", mendoj

prifti. Djali vazhdonte të përcillte lutje dhe pendesë me vështrimin e vagulluar, sepse gjuha i qe lidhur. Heshtte si vuv. Papu Kosta kuptoi se diçka të rëndësishme kishte për të thënë, ndaj e nxiti në rrëfim.

- Mos është sot dita e përkujtimit të ikjes së tyre në amshim?! Për këtë je kaq i trazuar? Mos ndonjë amanet nuk e ke çuar deri në fund? Nëse është kjo arsyeja e brengosjes tënde, këtu është vendi i duhur ku mund të falesh. Mund ta ndreqësh gabimin pa brerje ndërgjegjeje. Më thuaj, ç'të mundon?

Goja e djalit rrinte gjysmë hapur, pa nxjerrë zë. Pyetja e gurëzoi edhe më shumë, dukej sikur lypte mëshirë. Befas, tha vetëm dy fjalë, edhe ato të ngrira, të thata, shkurt.

- Ata nuk kanë vdekur!

“Ah, i shkreti djalë, - mendoj me dhembshuri papu Kosta, - po luan mendsh! Jepi kurajë dhe fuqi, o Zot, të dalë nga kjo dalldi!”

Fytyra e njomë qimepadirsur, buzët e thara nga makthi, sytë pellg me lot, vështrimi i përvuajtur, i ushqyen keqardhje të madhe priftit. Iu afrua me qetësi dhe e pyeti:

- A nuk vdiqën nga shpërthimi i depos së ushtrisë një natë tek flinin në kthinën e zënë nga ju?! A nuk ishte kjo arsyeja që more malet dhe erdhe gjer këtu?! Kujtohu, pra, biri im! Mblidhe veten dhe zbrit me këmbë në tokë! Lëri ata në mbretërinë e qiellit! Largoje dëshpërimin dhe jeto pa makthe në zemër! Jeta duhet jetuar, pavarësisht dhimbjeve, brengave dhe kujtimeve të hidhura. Drita e Perëndisë do të udhëheqë udhën dhe me vullnetin e Zotit do ta gjesh gëzimin. Kurajë, bir, kurajë!

Mbaroi ligjërimin duke i rrahur shpatullat lehtë. Por djali mbeti edhe ca çaste të tjera vuv, duke menduar se kishte rënë papritur në grackën e ngritur vetë. Pikërisht, ashtu i pati thënë në ditët e para të mbërritjes aty, se kishte shpëtuar, për fatin e tij të mirë, ngaqë nuk qe ndodhur në shtëpinë e tij mbrëmjen kur ra zjarri, por në shtëpinë e një shoku të tij moshatar. E kuptoi se nuk do ta kishte të lehtë të sqaronte gjithçka mbi të vërtetën. Sepse, tani, e vërteta nuk do të ishte aq e kulluar në gjykimin e tij, sa ishte në fakt. Ndenji ashtu i heshtur edhe pak kohë, për të mbledhur veten. Pastaj, i zgjuar nga përhumbja, puliti qepallat, uli disa herë sytë përdhe e disa herë i ngriti, ngaqë nuk e nguliste dot vështrimin në sytë zhbirues të priftit. Filloi të belbëzonte me përtim dhe frikë.

- Ata nuk kanë vdekur, papu! Ata nuk kanë qenë asnjëherë!

Papu Kosta e pa i çuditur! “U çmend”, tha me vete. Po, si u kthjellua mirë, vuri re që djali, pavarësisht se fliste me frikë dhe përtim, ishte i sigurt dhe i vendosur në ato që thoshte. Atëherë, u ngrit vrik në këmbë, i qëndroi përballë si ndonjë korb i stërmadh. I bërë disi nervoz nga e gjithë kjo ngatërresë që s’po merrte dot udhë, foli me zërin e plotë, autoritar, duke e hedhur pas krahëve butësinë atërore dhe qetësinë e njeriut të perëndisë.

- Nuk po të kuptoj, biri im! Më duken lojëra fjalësh këto që po më thua!

Nuk ia shqiste shikimin zhbirues djalit, i cili u hutua nga ndryshimi i karakterit të bisedës. Veç nuk e humbi toruan. Me po atë pendesë në fytyrë dhe me po atë siguri të mëparshme, foli më shkoqur dhe më qartë. Fjalët i

artikuloi rrjedhshëm dhe prerë, me të njëjtin ritëm që i dha bisedës prifti.

- Nuk kanë qenë asnjëherë, papu! Nuk kam pasur kurrë prindër. Jam një jetim prej ditës së parë të lindjes. Kurrë nuk i kam njohur prindërit e mi! Kurrë!

E gjithë qenia e tij qe kthyer në një përvuajtje rebeluese. E shikonte priftin, jo më sikur kërkonte mëshirë, po sikur kërkonte shpagim për fatin e tij të egër, sikur i kërkonte pse-në, atë pse që e dinte se askush nuk do të mund t'ia thoshte, aq më pak ai që kishte përballë dhe e shihte me habi, fytyrëngrysur. Si pushoi djali, prifti mori drejtqëndrim. Tha me zë të rreptë:

- Domethënë, na paske gënjyer!

Djali u tërhoq pas i trembur. Fjalët e vrazhda, fytyra e ngrysur dhe qëndrimi prej grabitqari të ngrëfësuar mbi prenë e vet e bënë të ndiente frikë. Kishte thënë padashur të vërtetën, të cilën e kishte fshehur prej ditës së parë që kishte bujtur në atë kishëz. Dhe e kuptoi se zbulimi i pavetëdijshëm mund të kthente përmbys gjithë situatën. Ky mendim e kruspulloi nën vete, e bëri një grusht, aq sa, tani, dukej se lypte vërtet mëshirë.

Prifti bëri një hap para, i qëndroi mbi kokë, sikur do ta gllabëronte atë qenie të mjerë. Fytyra po e ngrysur, shikimi po i rreptë, vetullat bashkuar mbi hundën e gjerë me kurriz dhe mjekrën rrëzuar në gjoksin e madh. Ishte i gjithi një stuhi gati të shpërthente. Por foli butë, përzier me ironi dhe cinizëm, gjithsesi.

- Domethënë, në këtë shtëpi të Zotit paskemi strehuar një të pabesë!

Djali brofi më këmbë si ta kishte pickuar gjarpri.

- Nuk jam i pabesë! Nuk kam bërë asgjë të keqe! - tha me një frymë.

Prifti e shtyu supeve të ulej dhe ai ra përsëri në vendin e tij. Shihte me ndjenjë kundërshtimi dhe pafajësie priftin, i cili vazhdonte t'i qëndronte përballë, stoik, si skifter gati për sulm. I foli autoritar:

- Të gënjesh bamirësin tënd, shpëtimtarin tënd, njeriun që të dha dorën e të hoqi nga rruga, nga mjerimi, nga vuajtja, nuk qenka asgjë e keqe, sipas teje?! Të mashtrosh njeriun e Zotit, brenda në shtëpinë e Zotit, mes ikonash dhe shenjtorësh, të cilëve u ke premtuar mirënjohje, nuk qenka asgjë e keqe, sipas teje?! T'i shmangesh të vërtetës nën dritën e Zotit, nuk qenka asgjë e keqe, sipas teje!? Këtë do të thuash? - përfundoi me ton sfidues.

Djali u hutua. Gjuha iu lidh përsëri. Puliste qepallat pa gjetur rrugëzgjdhje për shfajësimin që do të duhej të bënte. Shihte në sytë e zemëruar të priftit furtunë. Si t'ia shpjegonte gjithë ç'kishte ngjarë? Sa do ta besonte? I binin si çekan në kokë këto pyetje dhe shtigjet e daljes nga kjo situatë më shumë i mbylleshin sesa i hapeshin. Iu kujtua dita kur mbërriti aty. Kërkoi të kalonte në një skaner të shpejtë kujtese të gjitha ato që ndodhën atë ditë, gjer mesnatën kur i erdhi shpëtimi si prej dorës së Zotit, por papu Kosta u rrotullua me vrik në të djathtë të tij, rrëmbeu ca copa letre mbërthyer me thumba metalikë në një tabelë kompensate, rrethuar anë e mbanë me kornizë ristelash në ngjyrë ari dhe u kthye përsëri në pozicionin përballë djalit. Ia zgjati një rën syresh.

- Lexoje ç'thotë! - e urdhëroi. - Apo mos i kemi vënë atje të zbukurojnë murin?! Ato duhet të zbukurojnë shpirtin, o njeri, shpirtin!

Djali e mori letrën pa i hedhur sytë në të. Me zë të mekur tha:

- E di përmendësh.

Prifti e vështroi mosbesues, por djali nisi të flasë pa ia ndarë shikimin priftit:

*Lum njeriu që nuk ecën sipas këshillës së të pabesëve, që nuk ndalet në rrugën e mëkatarëve dhe nuk ulet bashkë me tallësit, por që gjen kënaqësinë e tij në ligjin e Zotit dhe që mendon thellë ditë e natë mbi ligjin e tij. Ai do të jetë si një pemë e mbjellë gjatë brigjeve të ujit, që jep fryt në stinën e tij dhe gjethet nuk i fishken; dhe gjithçka bën do të ketë mbarësi. Të tillë nuk janë të pabesët, ata janë si byku që era i shpërndan. Prandaj të pabesët nuk do të përballojnë gjykimin, as mëkatarët në kuvendin e të drejtëve. Sepse Zoti njuh rrugët e të drejtëve, rruga e të pabesëve të çon në shkatërrim.*

Kur ai mbaroi së thëni psalmin, prifti ia rrëmbeu nga dora letrën, e nguli sërish me thumb te tabela prej kompensate në mur dhe, pasi mori sërish atë pozicionin që djalit filloi t'i neveritej, pra, përballë e i ngrefosur, sikur do ta hante, ia ktheu:

- Aq më keq kur i di dhe i shpërfill, i përçmon, i hedh pas krahëve.

Dukej më i zemëruar se më parë. Zëri iu rrotullua nëpër dhomë si një ortek dëbore, qosh më qosh, me oshtimën që përplasej nëpër muret, tavanin e orenditë përreth, sikur donte t'i merrte përpara e t'i përplaste diku.

Në fund, e ndali hovin e frikshëm në veshët e djalit. Papu Kosta vazhdonte të qëndronte përballë si një shpend gjigant, në pritje të reagimit të tij, që nuk vonoi.

- Nuk kam bërë mëkat, - tha pa ia ndarë shikimin. - Nuk jam i pabesë, as mosmirënjohës! Jam një fatkeq dhe kaq.

Shpendi gjigant përballë tij u zvogëlua, iu çngryps fytyra, vetullat iu shtrinë skajeve të syve. Sepse pa në sytë e tjetrit dëlirësi. I gozhduar nga ato që dëgjoji, po gjykonte veten mos po i binte më kot në qafë djalit me këtë mosbesim e, kësisoj, tani ishte gjuha e tij që u lidh. U mat të fliste në një çast, por u tërhoq shpejt, pasi nuk gjeti fjalët e përshtatshme për këtë gjendje. Mbetën të dy duke u vështruar sysh një copë herë, si të kërkonin mes tyre besën, të cilën, herë e mohonte njëri, herë e pohonte tjetri.

Jashtë vazhdonte ende të binte shi me rrëmbim. Heshtja në dhomë bënte që oshtima të dëgjohej më e plotë. Në dritare era përplaste lehtë, puq me xhamin, ca degë të ngarkuara me gjethe e lagështi. Currilat e ujit zgjatëshin poshtë si përrenj të vegjël.

Prifti fërkoji dy - tri herë me dorën topolake mjekrën e thinjur fije - fije, rënë mbi gjoks, në ato pak çaste tek ndenji menduar. Djali nuk ia ndante vështrimin, duke i sjellë një lloj bezdie të pakuptuar. Atëherë, papu Kosta u ul edhe vetë pas tij, me krahun rreth qafës. Dukej se stuhia në dhomë ishte fashitur, kurse jashtë era fërshëllente.

- Mirë, - tha papu me zë të shtruar. - Sot vajti vonë. Tani fli! Nesër do të vish në dhomën e rrëfimit të ma ndriçosh këtë histori të ngatërruar.



I mbështeti dorën në sup dhe i mëshoi ta shtrinte në shtrat. Djali nuk kundërshtoi, u shtri pa fjalë. Pastaj prifti i hodhi shtrojën sipër, u ngrit, shkoi te dera dhe fiku dritën. Uroi natën e mirë duke tërhequr derën pas. Si mbeti vetëm në ajodhimë mori frymë thellë, si i çliruar nga ndonjë barrë.

“Sytë i ka kaq të qartë, kaq të pastër, - mendoi, - të lënë të depërtosh në thellësi. Dhe në thellësi të tyre shoh dritë.”

Eci ngadalë përmes ajodhimës, duke iu lutur Perëndisë të pushonte shiu deri në mëngjes.

Afër agut stuhia u fashit, drita mbushi dhomën e vogël dalëngadalë. Nuk kishte vënë gjumë në sy! Pjesën e mbetur të natës e pati shtyrë nëpër mendime të rrëmujshme, me shikimin e pandarë përtej dritares, prej ku i vinin dhe i iknin pa pushim imazhe të vagëllimta. Sa më shumë mundohej ta harronte ëndrrën, aq më shumë i shfaqeshin vegimet e saj. Portreti i gruas i sillej nëpër dhomë e lemerisur dhe e malluar njëherësh, duke thirrur me zë buçitës “bir, bir, o bir!”, ndërkohë që veshët i kumbonin nga ai zë i dhembshur. Mundohej t’ia qartësonte tiparet, por ndonëse arrinte të shihte një portret pak a shumë të plotë, imtësi të tilla si ngjyra e syve, e flokëve, forma e buzëve... nuk i shquante dot.

Mes kësaj turbullire ai portret i përzihej me atë të zonjës Sofi, me sytë e zinj e të mëdhenj, me harkun e vetullave të ujdísur me lezet, me hundën e vogël e të rregullt si të një ketri, buzët e holla lyer përherë më ngjyrë të zbehtë dhe me faqet që sapo kishin filluar t’i vareshin e mjekrën me një vrimëz në mes. Fytyrës i dalloheshin ca rrudha sido që i mbulonte me makijazh, ndërsa flokët

kishin një ngjyrë të hirtë që ai nuk e kishte kuptuar nëse ishin të thinjur apo qenë të lyer enkas ashtu.

I shfaqej si atë ditë, me mallëngjim të thellë, përcjellë nga ai shikim i butë e i pikëllueshëm, që dukej se fshihte një si brengë a si dhimbje, a të dyja bashkë. E kishte vënë re prej ditëve të para atë grua, në ritualin e përditshëm; ndizte gjithmonë tre qirinj, bënte tri lutje me sytë mbi ikonën e shën Mërisë e ikte përherë e lotuar. Me kërshtëri e ndiqte prej ndonjë cepi të kishës derisa largohej përtej portës me hapat e vegjël e të trishtë. Atë ditë u ndeshën ballë për ballë. Sapo kishte pastruar altarin kur ajo hyri në kishë e po ecte drejt tij. Nuk iu bë të ikte tek e shihte të afrohej kaq misterioze, duke i dhuruar prej atje tej një buzëqeshje plot mirësi. Si u qas e pyeti në greqisht për diçka që nuk e mbante mend saktë se për çfarë. Përgjigjja e tij me gabime e bëri të dyshojë se nuk ishte grek, ndaj e pyeti: “Eise alvanos?”<sup>1</sup> Ai pohoi me kokë, pastaj i tha në shqip: “Po, shqiptar jam”. Atëherë ajo lëshoi një klithmë të përmbajtur: “Oh, mana mu!”<sup>2</sup>. Ia mori duart në të sajat, ia mbështeti në gji duke ia shtrënguar fort. E shikonte me përmallim sikur një të afërm që nuk e kishte parë prej vitesh. Dhe belbëzonte: “Ah, kliumështori im! Ah, pedhi mu! Ah, djalthi im!”. Fliste në të dyja gjuhët, duke e parë me sy përpirës si nën një pavetëdije molisëse. “Kështu ishte, si ti! Kaq ishte, kaq! Ah, mana mu! Ah, djalthi im!”

---

<sup>1</sup> Gr. - Je shqiptar?

<sup>2</sup> Gr. - Nëna ime!

Nga gjithë kjo skenë djali qe ngazëllyer si kurrë ndonjëherë, pa kuptuar gjë. Ajo e puthi në ballë dhe e mbështolli në gjoks për një farë kohe. Ndjeu aromën e trupit të saj të plakur, përzierë me një parfum të lehtë, por edhe një ndjesi mallëngjimi. Pastaj gruaja i kishte rrasur në xhep pesëdhjetë mijë dhrahmi, me këmbëngulje të rreptë, por të dëlirë, edhe pse i kundërshtoi mjaft dhe ishte drejtuar drejt altarit për të kryer ritualin, duke fshirë lotët me cepin e një shamie.

Pasdite, ia tregoi dhjakut Vasil ndodhinë me atë grua.

- Aha, - bëri ai, - është Zonja e Ajdonate; kështu i thotë vetes. Po këtu i thërrasin “e humbura”, pasi nuk dihet si është gjendur te ne. E bën përditë këtë ritual, pa munguar asnjëherë. Kur është e pamundur ose ndodhet larg, dërgon një vajzë të ndezë qirinjtë e të lutet në emër të saj. Thotë se lutet për shpirtrat e nënës, të burrit e të djalit. I ka humbur gjatë trazirave, teksa iknin për matanë kufirit. Askush nuk e di si ka ndodhur, as nëse janë gjallë apo kanë vdekur. Asgjë nuk dihet. Vetë zonjën e patën gjetur në pyll, gati të lajthitur. Fliste vetëm me veten kur e sollën, nuk i përgjigjej askujt. Nuk mbante mend asgjë, as emrin e saj. E mori në shtëpi një qyqe tjetër, një grua e ve, njeri pa njeri. Ajo e thirri Sofi, po në fshat, edhe për shumë kohë, e thërrisnin “e humbura”. Për ca muaj mori një kurë e pasi u bë më mirë nisi të tregonte pako gjë nga e shkuara. Thoshte se ishin ngatërruar në pyll me të afërmit e nuk i kishte gjetur më. Sa herë e tregonte këtë histori psherëtinte e dëshpëruar: “Ah, mana mu! Ah, djalthi im, klumështuari im!”. Po s’e besonte kush. Tani

jeton vetëm. Megjithatë, mbahet mirë e vishet me sqimë. Duket, do të ketë qenë vërtet një grua zonjë atje në vend të vet sepse, sidoqoftë, ca veprime dhe sjellje zonjash të fisme nuk i ka harruar. Veç ka mbetur një qyqe që vajton fatin e zi një jetë.

Këto i tha Vasili për atë grua e prej asaj dite nuk iu hoq nga mendja. Jo vetëm për fatin e zi, por edhe për atë dashuri që i dhuroi ato çaste. I dha të kuptonte, qoftë edhe për pak, ç'ishte dashuria e nënës. Dhe për të kjo ishte si të zbulojë kuptimin e jetës. Prej asaj dite shihte ëndrra, pothuajse çdo natë, me portrete grash të mallëngjyera, të dhembshura, të ligura nga brengat, nga ndarjet, nga pritjet dhe harrimet. Por ajo e mbrëmshmja paskësh qenë më torturuesja. Për herë të parë iu përhit portreti i nënës, të cilën, nuk e kishte parë kurrë, por edhe nuk kishte reshtur kurrë së menduari, që e thërriste dhe e thërriste me mall e drithërimë. Veçse, nuk i pati ardhur ashtu si e përfytyronte ai, të bukur, të qeshur, të ëmbël. Iu shfaq një portret i paqartë, me trajtat që humbitnin në një mjegullnajë të çuditshme, ashtu si gjurmët e fatit të tij. E kishte munduar gjithmonë kureshtja për të ditur se ku vallë ishin hedhur ato zare kaq të mbrapshta të atij fati dorështrënguar? Por, përgjigje nuk pati asnjëherë. E ndonëse fatin e pati të tillë, ishte përpjekur të merrte nga jeta më të shumtën e mundshme, por e shihte se nuk mund të bënte më tepër se një pemë në shkretëtirë. I nevojitej, të paktën, një curril i përhershëm të ujiste rrënjët e eshkëta në atë shkretëtirë përvëluese. Kësisoj, ndryshe do të qe edhe ai, sido të kishin qenë prindërit, qoftë edhe një prej

tyre; të thjeshtë apo me pozitë, ama nuk do qe pa krahë, pa një ndihmë, pa një këshillë, pa dashuri. Me siguri nuk do të ishte ky mjeran nën kubënë e kishës, futur në këtë siklet të kotë vetëm sepse kishte shtrembëruar pa ndonjë qëllim të keq të shkuarën e tij.

Hamendësimet sesi mund të dilte nga kjo situatë i shpërbëheshin pa asnjë përfundim, si retë në qiell të hapur. I lodhur nga mendimet kridhej në pamendim. Për t'i shpëtuar kësaj përhumbjeje përmblihte gjithçka në një frazë të vetme: janë punët e Zotit. Dhe hidhte sytë mbi ikonën e shën Mërisë në murin përballë, bënte kryqin tri herë, lutej të dilte sa më lehtë nga kjo ngatërrësë.

Përtej dritares agu pastronte kupën e qiellit nga nata, qashtërsia e ditës hynte me forcë në dhomë.

*Qiejt tregojnë lavdinë e Perëndisë dhe kupa qiellore shpall veprën e duarve të tij.* Psalmi i erdhi vetiu ndër mend tek shihte i përhumbur tej dritares. Zoti di se ç'bën, tha, për t'i dhënë shpresë vetes.

Kambana e kishës e shkëputi nga mendimet dhe nga shtrati. Dhjaku Vasil po i binte i vetëm, pa e shqetësuar. "I ka treguar për ngjarjen e mbrëmshme, qëkurse nuk më bëri zë", - mendoi. Bëri kryqin përsëri duke thënë lutjen e mëngjesit ndërsa mendonte rrëfimin përpara priftit.

Papu Kosta nuk e priti në dhomën e rrëfimit, por në dhomën e tij.

- Nuk është e nevojshme, ti je në shtëpinë tënde, - i tha.

Kjo e ngrohu pak djalin. I bëri shenjë t'i ulej pranë, në kolltukun e meshintë, të fryrë në mbështetëse dhe

në krahët si balenë, atje ku zakonisht priste miqtë. Nuk dukej i mërzhitur, por as dhe ndonjë çikë entuziazëm nuk kishte në fytyrë. Rrinte autoritar, si në ceremonitë e rëndësishme. Megjithatë, i mbizotëronte një butësi e dukshme në gjithë qenien.

Djali u ul në karrigen pranë, ku i bëri shenjë. E shikonte vëmendshëm, gati përpirës, për të kuptuar saktë nëse gjendja e tij e jashtme ishte vërtet qetësi apo vetëpërmbajtje e stisur. Por, papu Kosta qëndronte shpërfillës, me sytë e ngulur në ikonën e murit përballë, pa i dhënë mundësinë ta peshonte mirë këtë gjë. Kjo e futi në dilemë nëse duhej t'ia niste vetë rrëfimit, apo të priste fjalën e priftit, profili i të cilit, tek rrinte pa lëvizur, ngjante me një modelist piktorësh. Heshtja e zgjatur po i merrte frymën. Nuk duroi më.

- Papu, - i foli, për t'i tërhequr vëmendjen.

Ai nuk reagoi, vetëm puliti qepallat. Pastaj buzët i lëvizën përtueshëm.

- Të pabesit i ndodh ajo nga e cila trembet, por njerëzve të drejtë u jepet ajo që dëshirojnë, - foli me zë të shtruar e të pastër, si në meshë.

-Po, - tha me drojë djali, - e di. Ndaj jam këtu, të them të vërtetën.

Prifti u kthye nga ai. Buzëqeshi me qesëndi.

Ende është i zemëruar, mendoi djali i shqetësuar se ndoshta biseda nuk do të shkonte mbarë.

- Nuk më thua, bir i Perëndisë, ç'të shtyu të gënjeje shpëtimtarin tënd?

Djali u përtyp dëshpërimisht. Nuk i pëlqeu ky fillim bisede. Me siguri i ka mbetur hatri shumë, mendoi, ende

mban inat. Por, sytë, megjithatë, ia nguli priftit me guxim.

- Papu, - iu drejtua i qetë dhe i vendosur, - kam mësuar pothuajse gjithçka nga fjalët e urta, i di urdhëresat përmendësh, e di ç'thotë Perëndia për mashtruesit, mosmirënjohësit dhe të pabesët. Dhe nuk i kam harruar asnjëherë, asnjë çast. Dhe kurrë nuk kam gënjyer, kurrë nuk jam treguar mosmirënjohës. As i pabesë. Kam vepruar ashtu si këshillojnë librat e shenjtë. Do të rrëfej e do të kuptosh që nuk ia kam me hile as Perëndisë, as ju. Askujt nuk ia kam me hile. Do të t'i them të gjitha, papu.

Prifti buzëqeshi këtë herë nën një hije mosbesimi, por fjalët e djalit i shkuan në zemër. I hodhi një shikim të paqtë, fërkoji mjekrën dy - tri herë me dorën topolake, u shtriq në kolltukun e rehatshëm, kryqëzoi krahët mbi kraharor dhe foli, duke e ftuar në rrëfim, njësoj si u drejtohej mëkatarëve.

- Më rrëfe, o njeri i Perëndisë, po të dëgjoj!

Pikërisht në këtë çast djalit iu bënë lëmsh gjërat në kokë. Përpara se të nisej për aty, i pati renditur mirë e mirë fjalitë me të cilat do të fillonte rrëfimin. Pastaj të tjerat do të ecnin vetë, sepse e kishte të qartë çfarë do të tregonte. Po, ja ku iu bënë lëmsh të tëra dhe rrinte tani i shushatur para priftit. Heshtja, e cila pllakosi pas hutimit, i rëndonte sa një mal. Megjithatë, vendosi shpejt të fliste, ashtu si t'i vinin fjalët, vetëm të mos zgjaste shumë ajo heshtje, të cilën prifti mund ta merrte si një përpjekje mashtrimi.

- Mbeta rrugëve, - tha, duke mbytur drojën dhe hutimin, - njeri pa njeri dhe vendosa të ikja. Erdha këtu.



Për t'i dhënë të kuptonte se nuk tha ndonjë gjë të re, prifti vazhdoi të qëndronte shpërfillës, pa i hequr sytë nga ikona e shën Mërisë. Ndonëse i shpërqendruar, djali e vazhdoi ligjërimin pa e humbur toruan.

- Ajo ç'të kam thënë për prindërit e mi nuk është e vërtetë. Është një sajesë, por nuk ka qenë zgjedhja ime. Falmë për këtë mëkat! Nuk e di fatin e tyre, nuk i kam njohur kurrë.

Priste reagimin e priftit. Ky hoqi sytë nga ikona në mur, e vështroi vëmendshëm, me kureshti, duke e shtyrë të vazhdonte.

- Jam rritur në Shtëpinë e Fëmijës, kështu i quanim vendet ku i çonin jetimët. Ose thjesht i quanin "jetimore". Shumë të tjerë i quanin brefotrof. Dikush më kishte dorëzuar në atë vend. Nuk di më shumë. Nëse ishte nëna ime apo tjetër njeri ky dikushi, nuk ma thanë. Kur pyesja për prindërit, me shpresë se një ditë diçka do të dilte në dritë, nuk merrja tjetër përgjigje veç asaj që dija; që dikush më kishte sjellë aty në një mëngjes të ftohtë janari. Vetëm kaq. Pasi kuptova që këmbëngulja për këtë ishte e kotë, nuk pyesja më. Iu nënshtrova fatit pa kushte, si edhe të tjerët. Nuk kishte rrugë tjetër. Aty na thoshin se shteti do të përkujdesej të ishim të barabartë kur të dilnim në jetë, si dhe ata jashtë asaj strehëze. Kështu na thoshin. Ne as i kuptonim këto, as nuk e dinim si rriteshin të tjerët në shtëpitë e tyre, me familjet e tyre. Jetonim jetët tona në vetminë e të afërmve dhe në vëllazërinë e jetimëve. Kishte edhe nga ata që nuk ishin fare vetëm. U vinin nënat e i takonin, ose baballarët, apo njerëz të

afërt. Përqafoheshin të përmalluar, me duart plot dhurata. I puthnin, i shtrëngonin ndër krahë fort, u thoshin fjalë të ëmbla, të bukura, të mira. Ne të tjerët rrinim mënjanë, të shastisur nga ajo dashuri e paprovuar, të etur për atë përqaqim, për ato lloj puthjesh, për ato fjalë të ngrohta. Ngushëlloheshim me shpresën se një ditë do të bëheshim të zotët e vetes, madje do të bëheshim të aftë edhe për atdheun, ashtu si na e përsëritnin shpesh. Do të bënim familje, të rronim si të tjerët në një shtëpi tonën, së bashku. Dhe i shtynim ditët në atë strehëz me shpresën e mbërritjes së asaj dite.

Diçka mallëngjyese e shpoi djalin në gjoks, ndaj e ndërpreu rrefimin. Ishte diçka e papërcaktuar, si brengë a si peng ngjeshur aty brenda. Prifti dëgjonte me kujdes çdo fjalë, vërente me vigjilencë çdo gjest, çdo drithërimë të buzës. Djali u mbush me frymë thellë, për të marrë ca energji të tjera për vazhdimin. Prifti e la të qetësohej.

Në dhomë që kthyer heshtja e thellë. Hapësira ishte mbushur plot dritë ngaqë dielli, pas stuhisë së mbrëmshme, shkëlqente fuqishëm dhe rrezet mësynin nga të gjitha dritaret.

- Me atë ëndërr në mendje dolëm një ditë prej asaj strehëze bonjakësh, - e theu heshtjen djali. - Por, erdhën vetëm ditë të zymta, pa shpresë. Fillimisht iu gëzuam lirisë, si qeni kur zgjidhet nga zinxhiri. Ishim tashmë jashtë atij vendi, ku na mbanin me hir e me pahir. Nuk na komandonte më kujdestarja, nuk na futnin më me urdhër për të ngrënë, për të mësuar, për të luajtur, për të fjetur e për t'u zgjuar. Ishim të lirë e mund të bënim ç'të donim,

si gjithë ata që i patëm zili dikur, jashtë mureve rrethuese. U ndiem vërtet të tillë në këtë vorbull lirie, por shpejt e kuptuam se kurrë nuk do të ishim si të tjerët, kurrë! Fati qe prerë për ne njëherë e përgjithmonë, nuk mund të ndryshonte më...

Ndaloj përsëri, pa ia ndarë vështrimin priftit që dëgjonte gjithë sy e veshë. Ai e pa ngushëllueshëm. E ftoi t'i ulej më pranë, i hodhi dorën në sup, e ngrohu së tepërmi me atë veprim paqësor. I afroi kokën pas vetes dhe i foli me zë të butë.

- Qetësohu, bir, qetësohu! Nëse nuk ndihesh mirë mund ta lëmë për njëherë tjetër vazhdimin.

E pushtoi pastaj me krahët e mëdhenj, e mbajti ca çaste ashtu. Djalit iu rizgjua mallëngjimi. Të tillë përqaftim nuk e kishte marrë dhe nuk e kishte ndier kurrë. Herë - herë, kur sillej mirë e përparonte në mësimet e teologjisë, të cilat prifti ia kishte vënë detyrë t'i mësonte me synimin që një ditë të mund bëhej jo vetëm besimtar i mirë, por edhe një kishtar i devotshëm, kishte marrë lavdërime plot mirësi prej tij. I kënaqur, papu i rrihte supet ose i fërkonte lehtë kokën a, me pëllëmbën e butë i ledhatonte faqen e, ndonjëherë, kur ishte shumë i kënaqur nga puna që bënte e puthte në ballë. Por, ky përqaftim i dhembshur gati sa nuk e bëri të shpërthente në ngashërim. Nuk donte ta jepte veten, nuk donte ta nxirrte atë ngashërim, që të tregohej burrë, të mos dukej i dobët përpara priftit. Por nuk mundi; e lëshoi veten i shkrehur pas atij përqaftimi, të cilit, aroma e rrobës kishtarë, përzier me një lloj parfumi të lehtë, i jepte një përmasë të ndjerë shpirtërore. Prifti i

përkëdhelte me dashuri kokën. Si iu qetësuan dallgët e mallëngjimit, i foli qetësisht:

- E lemë për njëherë tjetër, bir!

Djali tundi kokën në shenjë mosmiratimi.

- Duhet të t'i them të gjitha papu! Të jem i çlirët dhe i pastër në shpirt me ju dhe Perëndinë. Dua të zbrazem!

Papui nuk foli, miratoi edhe ai me kokë. Pasi mori frymë thellë, djali rinisi rrëfimin.

- Atë ditë u enda cep më cep nëpër qytet, gjer në mesnatë. Nuk lashë vend pa shkelur, rrugë më rrugë, lagje më lagje, sikur do të niseshja për diku nga nuk do të kthehesha më. Ishte dita e parë e jetës që e shijoja të plotë, pa rregulla, pa urdhra, pa ultimatume. Në mbremje më dukej vetja sundues i gjithë planetit; Hëna në qiell dhe unë në Tokë zotër të vërtetë. Nginja me liri vazhdoi derisa këmbët nuk po më mbanin më. Pafuqia më ndali buzë lumit të vogël, pranë urës kryesore, mbi të cilën ndiheshin gëlimet e fundit të ditës që shkoi. Qyteti ishte tkurrur nën vete, qe topitur. Gjallëria, zhurma, lëvizjet ishin shuar si në një dasmë të madhe të sapopërfunduar. Makinat qenë rralluar tepër, njerëzit edhe më tepër. Mesnata kishte mbërritur shpejt, me dritat e venitura e të rralluara, me heshtjen mbizotëruese çdo minutë e më tepër, me terrin e zymtë gjithandej. Një bosh i pakuptimtë vinte prej përtej, nga barku i errësirës e më kallte ndjesinë e braktisjes. Vetmia mes atij boshi të zymtë më trembi. U kujtova se nuk kisha një strehë ku të fusja kokën. Qarkova me një shikim të ankthshëm rreth e rrotull gjendjen. Pasiguria më mbiu në shpirt. Vështrova Hënë, si për të gjetur

atje shpëtimin, si i mbyturi që e kërkon edhe në një fije kashte. Dukej e zbehtë dhe po aq e vetmuar në qiellin e errët sa edhe unë në Tokë, prej ku e kundroja.

Ndërsa isha nën këtë psikozë pasigurie, diç fëshfëriu nën urë. Pastaj diçka lëvizi. Mendova se do të qe ndonjë kafshë; qen a mace endacake si puna ime, që kishte gjetur strehë nën urë pas bredhjes së gjatë rrugëve të qytetit. Poshtë urës nuk shquhej gjë. Një si hije u përvodh prej aty duke marrë dalëngadalë trajtën e një siluete të vogël fare, sa një kone, e cila, sa më shumë dilte në dritë, aq më shumë zmadhohej, derisa, për pak sekonda, kuptova se ishte një siluetë njeriu. U afrua drejt meje që rrija i hutuar në trotuarin e cepit të urës. Ishte një grua e dobët, veshur me fustan, të cilit nuk ia dalloja dot ngjyrën. Prej barkut të errët të nën urës doli një tjetër siluetë gruaje. Nuk e ndoqi pas të parën, por qëndroi aty, disa metra larg. Tjetra m'u ngul përballë. Mundja t'i shquaja fytyrën. Nuk ishte aq e dobët sa m'u duk së largu. Duhej të ishte rreth tridhjetë vjeçe, me tipare të rregullta dhe gjoks të madh. Buzëqeshte në mënyrë të shtirur. Ose të paktën ashtu m'u duk. Më hodhi një vështrim nga koka në këmbë, foli me zë të ulët, por të sigurt.

- Ec, or çun, pse ke frikë? - dhe sërish buzëqeshi, këtë herë me dinakëri.

Thashë “ku” shpejt e shpejt, i zënë gafil nga kjo ftesë e papritur. Ajo qeshi. Ktheu kokën nga shoqja që ndiqte skenën aty poshtë. Qeshi edhe ajo me kukurimë. Nuk e dalloja mirë, veç kukurimat i erdhën të qarta. U ndjeva i vënë në lojë dhe një inat më kapi së brendshmi. As i

njihja, as e dija kush ishin, as kuptoja ç' donin. Ndërkohë, gruaja përballë zuri gjinjtë e saj të mëdhenj me duar dhe m'i tundi para syve. I hutuar edhe më keq, bëra një hap pas, ndërsa ajo një hap para.

- Se paske bërë asnjëherë?! - tha dhe qeshi me të madhe.

E qeshura i kumboi nëpër natën e zbrazët e unë bëra një hap tjetër pas. Ajo iu drejtua shoqes po duke qeshur: "Qenka i paprishur i shkreti!". Së poshtmi urës u dëgjuan përsëri kukurima të zvargura. Nuk kuptoja asgjë nga ato që thoshin dhe pyeta instinktivisht:

- Çfarë?

- Hajde ta bëjmë atje, - tha dhe tregoi me dorë poshtë urës. - Për ty do të jetë badihava, sepse e paske sefte.

Sërish nuk kuptova gjë. E vështrova gjithë zemërim. Ajo vazhdonte të qeshte, shihte herë shoqen poshtë urës, herë mua të shastisurin.

- Hajde, or çun, provoje i her se qenke për gjynof! - tha pas pak.

Por, nuk më la kohë të gjeja ndonjë përgjigje, zgjati dorën mes shalëve të mia të më kapte lulet. Unë u sprapsa vrik.

- Ke apo s'ke, or çun, pse hutohesh? Eja bëhu dhe ti burrë! - ia priti.

M'u duk sikur ajo nuk foli, por sokëlliu dhe atë që tha e dëgjoi gjithë bota. U sprapsa disa hapa të tjerë i frikur dhe i turpëruar nga veprimi e fjalët e saj të pacipa. Të dyja ia dhanë të qeshurës me të madhe. Pastaj, që poshtë urës erdhi një zë i hollë, gërvishtës.

- Merre moj të shkretin, merre të flejë ngrohtë sonte!

Ndërkaq u hodha përtej rrugës, ia dhashë vrapit për në qendër të qytetit. Në lulishten e parë që hasa u ula në një stol. M' u deshën disa minuta të rregulloja frymëmarrjen. Ndihesha i rraskapitur. U shtriva me fytyrë nga qielli, duke menduar atë që sapo më kishte ndodhur.

“Patjetër ishte ndonjë kurth prej të cilit kisha shpëtuar për mrekulli, - mendoja, - ndryshe kushedi si do kishte vajtur puna.”

Duke vështruar yjet në qiell më zuri gjumi.

U zgjova nga një fëshfërimë. Një grua me fshesë shqope në dorë më shihte pak metra më tutje. Nuk po e mblidhja veten dhe nuk po kuptoja asgjë nga gjithë ç'shikojta rreth e rrotull. Gruaja, një rome topolake, mbuluar kokën me shami, u afrua dhe tha pa m'i hedhur sytë: - Ruju nga pluhuri, or çun! - dhe filloi të fshinte pa u larguar ende unë. U çova dhe u zhvendosa pak më tutje, për t'iu shmangur pluhurit që ngrinte fshesa e saj e vjetër e mbetur më shumë një shkarpë sesa fshesë. Duke dalë nga përgjumja kuptova se natën e parë të lirisë e kisha kaluar në stol të lulishtes.

Djali pushoi një grimëherë. Vështronte priftin që, në padurim, e nxiti të vazhdonte.

- Ç'ndodhi më pas?

- Më pas kuptova edhe atë që më priste në të vërtetë. Mbas ditënatës së parë plot eufori lirie, zbrita me këmbë në tokë. Xhepat pa një kacidhe dhe nata, që do të më zinte përsëri pa një strehë ku të fusja kokën më bënë të ndihesha ligisht. Mendova Durimin, shokun tim të ngushtë

në shtëpinë e fëmijës, larguar para gjashtë muajsh, por që ishte rregulluar në një servis makinash si mekanik. Vendosa ta takoja. Ndoshta më gjente ndonjë punë ose më jepte ndonjë mendim se ç'mund të bëja. E gjeta te puna, me ca rroba gjithë vajra e graso, nën një makinë "Benz 240", futur poshtë gropës. I thirra në emër e ai doli vrik prej aty me atë buzëqeshjen e çiltër që nuk i ndahej kurrë. M'u hodh në qafë; sikur kishim vite pa u parë. Tha se kishte qëndruar për pak kohë te ca të afërm të tij, por pasi kishte filluar punë flinte aty, në një dhomë të sajuar me kompensata, duke bërë edhe rojën e natës. Si mbaruam së rrëfyerit secili të vetat prej ditës së ndarjes, më tha se i kisha ardhur si me porosi. Sipas tij, na ishte dhënë një mundësi që mund të na bënte me një strehëz. Këtu fle si qen, tha, nuk shtyhet më. Dhe më tregoi se diku, në rrethinat e qytetit, ndodhej një repart ushtarak i braktisur, shumica e mjediseve të së cilit ishin zënë nga banorë të ardhur prej zonave të thella. Duhet të shkonim sa pa i zënë të gjitha dhomat ardhacakët që ia behnin dita-ditës. Kështu që u nisëm sapo ai la punën.

Ish-reparti më ngjau si një kamp refugjatësh, kaosi binte në sy menjëherë. Zhurmë dhe potere gjithandej. Zallamahinë më të madhe e bënë fëmijët, që silleshin duke vrapuar nëpër oborrin e madh e ca të tjerë, hipur mbi paralelet e hekurta të një fushe të vogël stërvitjeje, bërtisnin e ulërinin me të madhe. Gratë, gjithashtu, komunikonin me zë të lartë, në dialekte të ndryshme. Disa mobilie të vjetra ishin lëshuar aty-këtu në mënyrën më të pakujdesshme, si dhe objekte të tjera shtëpiake, boçe



të mëdha rrobash sajuar me çarçafë a batanije. Godina nuk qe fort e keqe, me përjashtim të mungesës së disa dyerve dhe dritareve të grabitura, edhe shumë xhamave të thyer. I erdhëm rrotull godinës së braktisur nga ushtarët e të ripushtuar nga ardhacakët, për të parë situatën. Në krahun e djathtë, përballë një shpati kodre, gjetëm të lira dy dhoma të ngushta, tip kthinash. Ndoshta, nuk i kishin zënë ende ngaqë pozicioni i tyre ishte më i pavaforshmi; mu në cep të godinës; as dielli nuk i zinte, as fushëpamje nuk kishin. Po për ne këto nuk kishin shumë rëndësi, mjaft të kishim ku të futnim kokën. Për t'u siguruar nëse ato dhomëza ishin të lira, pyetëm një burrë rreth të gjashtëdhjetave që po sistemonte familjen në një dhomë të madhe, pesë a gjashtë metra me tutje.

- Zenie, mor burrë sa s'ka ardh kush me ta xan, se s'të thotë kush gja, - tha dhe vazhdoi në punë të vet.

Zgjodhëm dhomën më të mbajtur, atë që kishte derën, pasi dritaret të gjitha ishin pa xhama. I mballosëm dritaret me disa kompensata të vjetra të hedhura oborrit. Më pas, me ndihmën e disa banorëve rishtarë, sajuam dy shtretër të vjetër ushtarësh, dyshekë po të vjetër pambuku, bërë gati petë prej përdorimit të gjatë dhe një komodinë edhe më të vjetër, të cilën, fillimisht, e përdorëm për tryezë ngrënieje, derisa gjetëm një tryezë të vogël. Në atë godinë paskësh pasur ca dhoma me materiale të tilla, të cilat nuk u hynin më në punë autoriteteve ushtarake pas braktisjes së repartit si rezultat i reformave.

Pas dy - tri ditësh dhomëza jonë u mobilua thjesht me objekte të gjetura andej - këndeje rrugëve të qytetit. Më pas vumë xhamat, ndërsa rrymën elektrike na e lidhi një

prej banorëve, të cilin e thërrisnin “elektrici”, ngaqë merrte vesh nga kjo punë. Derës i vumë dry nga jashtë dhe lloz nga brenda. Dhe, ja ku u bë shtëpia! Ishim të kënaqur me të, ndonëse shumë larg kushteve të shtëpisë së fëmijës. Sidoqoftë, gëzonim se patëm fatin ta kishim një strehëz.

Pas kësaj më duhej të punoja. Fillova të bridhja çdo ditë cep më cep të qytetit duke pyetur. Pas orës katër të pasdites, pasi linte punën Durimi, kërkonim së bashku një punë për mua, gjersa nata na mblidhte në strehëzën tonë të re. Pata qëlluar të gjeja punë për një ose disa ditë në ndërtim, ngarkim - shkarkim, transport objektësh të tregtarëve nga pika e furnizimit deri te makina e tyre, e ndonjë tjetër. Kësisoj, edhe falë të ardhurave nga puna e Durimit, nuk patëm ndonjë vështirësi të madhe për ushqim, ndërsa veshmbathjen e zgjidhnim pa ndonjë kosto të lartë te “Gabi”. Por që të futesha në një rrjedhë sa më normale të jetës, shpresoja të gjeja një punë të përhershme. Mirëpo, na ndodhi ajo që nuk e prisnim; ndërsa ishim në kërkim të punës sime, humbëm shtëpinë, vetëm dy muaj pasi e kishim gjetur.

Atë pasmesnate u zgjuam nga ca zhurma dhe ulërima. Përtej dritares, një flakadan gjigant ndriçonte terrin. Të bërtiturat çirrnin natën me rrapëllimë:

- Nxitoni, shpëtoni kokën, shpëtoni fëmijët, shpejt, shpejt!

Thirrjet shtonin më shumë panikun dhe tensionin. Dolëm jashtë të lemerisur, sytë na u përdezën nga flakë të mëdha që ndrinin e tymosnin njëherësh. Dëgjoheshin

gjithandej ulërима, të qara fëmijësh, britma burrash të nervozuar, klithma grash në përpjekje për të shpëtuar prej flakëve ç'të mundnin. Përcëllima na pikte surratin, shtëllungat e tymit davariteshin prej erës, na bukosnin frymëmarrjen. Nxituam t'u iknim përcëllimës dhe tymit nëpër një çoroditje tmerruese. Disa dhjetëra metra larg vështronim të hutuar flakët që përpinin qiellin. Por, s'kaluan veçse disa minuta dhe, përmbi hutimin tonë, një breshëri automatiku jehoi frikshëm. Sundoi mbi gjithë ulërimat njerëzore derisa i mbaroi karikatori. Pastaj, të tjera breshëri ushtuan njëra pas tjetrës, për rreth dhjetë minuta. Askush nuk kuptonte ç'po ngjiste. Në atë panik të krijuar gjithsekush rendte për t'i shpëtuar së keqes, sulmonte të gjente një copë vend për t'u fshehur. Isha strukur pas trungut të një pemë, gati nja tridhjetë metra larg godinës që digjej, mbledhur kutullaç në tokë, me shpresën të qetësohej sa më parë situata e të mundja të zhdukeshë prej aty. Sapo krismat pushuan ia mbatha me të katra tatëpjetë rrugës, në drejtim të qytetit. As e kisha idenë se nga mund të gjendej Durimi. Në rrëmujë e në panik sekush kishte vepruar si ia kishte marrë mendja për të shpëtuar lëkurën. Vrapoja e ktheja kokën ndonjëherë, për të parë atë që lashë pas. Qielli ndrinte nga flakët si lubi. Ca sirena alarmi këlthitën dhe, pas pak, u duk një zjarrfikëse me fenelinat e verdha ndezur, që nxitonte për te ish-reparti. Ndala dhe e ndoqa me sy pavetëdijshëm derisa u zhduk në kthesë. Pasi ajo kaloi e më la në shushatjen time, pranë një kryqëzimi, vështrova sërish andej. Flakërima dhe reja gjigante e tymit dukeshin

ende. Rrëmbimthi pata një ndjesi të isha sa më larg asaj llahtarie të pakuptimtë e të rrezikshme. Pa asnjë mendim në kokë eca drejt qendrës së qytetit.

Dita që zbardhi më gjeti përsëri në rrugë, të pezmatuar dhe të pagjumë. Dhe me pikëpyetjen e madhe në kokë për atë që do të vinte më pas. Si fillim shkova te puna e Durimit, i bindur se do ta gjeja atje. Fatkeqësisht nuk ishte aty. Ustai i tij, njëherësh edhe pronari i servisit, tha se nuk ishte paraqitur në punë atë mëngjes. Kjo ma shtoi akoma më shumë mërzinë, por ç'mund të bëja? As dija ku e as dija kë të pyesja tjetër. Urova të ishte mirë dhe u largova për t'u endur nëpër qytet.

U rashë pash më pash rrugëve derisa dielli ngrohu fort, pastaj u shtriva në një stol lulishteje. Si gjeta prehje për trupin, humba prehjen për shpirtin. Mendime të shumta më sulmuan, të trishta, të pashpresa, të helmëta. Madje dhe të egra. Më bluante përbrenda mërzia, ndërsa koka më gjëmonte sikur mbante gjithë ulërimat e natës në një kasetë që s'pushonte e s'pushonte. Hidhëroheshja për fatin e mbrapshtë, egërsoheshja me botën e vrazhdë, tmerroheshja nga e nesërmja e mistertë. Shaja me vete, zemra sa s'më plaste prej zemërimit. Kështu, me dufe shtyva disa minuta, gjer kur dielli më ngrohu mirë e mirë e më vuri në gjumë si ndonjë bebe.

Më zgjuan, nuk e di pas sa kohe, ca zëra të rrëmujsëm, me ton të lartë, plot nerv. Ngaqë ende isha nën sundimin e ankthit të djeshëm, hova i trembur në stol. Disa djem, pak metra më tutje, bisedonin zëlartë pa u merakosur për ç'kishte përreth. Fillimisht i mora inat për gjumin e

prishur. Rrija mbështetur dhe dëgjoja i bezdisur bisedat e tyre të zjarra. Ishin pesë vetë, por vetëm dy prej tyre debatonin, të tjerët dëgjonin në heshtje. Kuptova se bëhej fjalë për një grup, i cili duhej të nisej në Greqi, si shumë e shumë të tjerë asokohe të zymtë. Debatu që ndezur për vendin nga ku do të kalonin kufirin. Djaloshi i gjatë, thatim e flokëkashtë, ngulte këmbë për Devollin. Mbronte idenë se terreni andej është më i butë dhe se rrugën e dinte symbyllur. Tjetri përballë, më i shkurtër dhe i plotë, kokëmadh e flokëzi, përsëriste e përsëriste se Gramozi ishte më i lehtë për t'u kaluar. Thoshte se kishte qenë ushtar në ato anë dhe e njihte mirë zonën. Edhe kontroll, thoshte, ka më pak. Pas rreth njëzetë minutave diskutime e kundërshtime vendosën për Gramozin. Si u vendos kjo, nisën të shqyrtonin detaje të tjera të rrugëtimit.

Dëgjoja shpërfillës bisedën e tyre me sytë mbyllur, nën këndelljen përkëdhelëse të diellit. E ndodh që, në çast, të vjen vetëtimthi në mendje ndonjë ide. Sidomos në një gjendje dëshpërimi si e atij mëngjesi, kur kërkon pandërprerë një shteg për të dalë nga amullia. Gjykova: i humbur që i humbur, pse nuk ikja me ta? M'u mbush mendja se fati më kishte ardhur kaq pranë e nuk duhej ta lija të më ikte. Dukej sikur zaret hidheshin një herë bardh e një herë zi pas çdo radhe. "Gjithkush e ka një dorë fat", thoshte Leta, pastruesja e shtëpisë së fëmijës, kur ne diskutonim fatet tona. Ndoshta kjo është dora e fatit, i thashë vetes, do të jetë marrëzi ta lësh të të ikë. Nuk u mendova gjatë, u çova vrik dhe iu afrova djemve. I dëgjoja tani me kureshtje. Hodha ca hapa të tjerë, të vegjël, drejt tyre. Druaja t'u flisja, ngaqë kisha frikë mos

nuk pranoin. “I humbur që i humbur je”, i dhashë sërish kurajë vetes dhe u qasa. Ata më panë me dyshim, ndaj nxitova t’u tregoja hallin. Po kuptova se halli im nuk ishte edhe i tyre. Pa ndonjë interes dëgjuan ç’u thashë. Dukeshin ashiqare mosbesues. Ndoshta pamja ime e mjerë pas natës së frikshme dhe brishtësia e kurmit ua jepnin këtë të drejtë. Sytë u shprehnin qartë një “ç’na çan kokën”. Pastaj foli ai që mbrojti idenë e kalimit të kufirit nga Gramozi. Tha se nuk kishin nevojë për ferra nëpër këmbë në atë rrugë të gjatë dhe me rreziqe. Nuk kishin asfare dëshirë të merreshin me mua. Dhe s’kishin faj; ç’mund të ofronte, si shpërblim, një mjeran si unë? Megjithatë nuk u dorëzova. Ua shpjegova gjithë historinë e jetës sime dhe u premtova se nuk do t’i bezdisja dhe nuk do t’u sillja asnjë problem, veç të më merrnin me vete, sepse s’kisha rrugë tjetër. U thashë se detyrimin tim do t’ua jepja një më një sapo të gjeja ndonjë punë andej matanë. Së fundmi u bindën. Ndoshta më mëshiruan ngaqë isha njeri pa njeri, ndoshta keqardhja u foli për ndonjë pendesë të mëvonshme, ndoshta premtimi se do ta merrnin shpërblimin i bindi të pranoin. Kushedi?! Por kjo nuk kishte pikë rëndësie, përveç faktit që vendosën të më merrnin. Kushti i vetëm ishte se nëse më ndodhte gjë, askush nuk do të mbante përgjegjësi, sepse ato punë ashtu e kishin; asnjëherë nuk u dihej. Sigurisht pranova menjëherë. E kush do t’u kërkonte llogari për mua nëse më ndodhte gjë?

Pauza që pasoi risolli heshtjen brenda kishës. Nga jashtë vinin cicërimat e zogjve, prelude të një dite të bukur. Dielli shkëlqente më me forcë, drita që bërë më e bollshme dhe tej dritareve, degët e pemëve, të qetuara, dukeshin si peizazh në akuarel.

- Paske hequr shumë, biri im, - tha mëshirueshëm prifti. - Dhëntë bekim Zoti i lavdërueshëm, por as më thua, pse duhej të më gënjeje?!

Djali vuri buzën në gaz pa mundur të dalë krejt nga trishtimi. Kujtimet e hidhura ia vinin përposh shpirtin, ndonëse mundohej të ishte i qetë.

- Do ta them, - u përgjigj. - Dhe shpresoj se Perëndia do të më falë. Edhe ju, papu!

Prifti tundi lehtë kokën, pa u kuptuar nëse pohonte apo mohonte në atë mënyrë. Pastaj bëri një shenjë që do të thoshte se ishte i gatshëm të dëgjonte më tej. E djali, më i qetësuar tashmë, vazhdoi:

- Ditën u enda nëpër qytet, natën e kalova te stacioni i autobusëve. E kishim lënë të niseshim në pesë të mëngjesit, por meraku se mos ishin tallur me mua s'më la të mbyllja sy. Pa zbardhur dita mbërritën shoferët e

autobusëve e, pak pas tyre, dy çunat që debatonin ditën e shkuar për kalimin e kufirit. Iu qasa atyre me një gëzim të fshehur, që nuk më kishin mashtruar.

Për disa minuta gjithë grupi ishte gati për udhë, gjithsej trembëdhjetë vetë, duke zënë thujt gjysmën e autobusit.

Në qytetin e vogël juglindor mbërritëm rreth orës dy të mesditës. Qe ditë e nxehtë gushti, megjithëse me vapën e Tiranës nuk kishte të krahasuar. I dolëm qytetit nga pas, lamë edhe fshatin ngjitur me të e ndaluan në një lëndinë të vogël. Djali me trup të shkurtër, të plotë, kokëmadh e me flokë të zinj, të cilin e thërrisnin herë Niko e herë Kapo, dha porosinë e fundit.

- Mos flisni me zë të lartë e mos bëni zhurmë. Si këtej edhe matanë, sepse keq me ushtarët tanë, më keq me ata të grekut. Ka pasur raste që këta tanët i kanë dorëzuar në postën kufitare refugjatët, i kanë futur edhe në burg. Ata matanë edhe i kanë rrahur, i kanë prosvalur, i kanë vrarë e i kanë hedhur ferrave; ç'nuk u kanë bërë! Sa të bjerë pak vapa do nisemi, do ecim kësaj grykës këtu, gjer në krye. Këtë e rrahin më pak ushtarët. Në të ngrysur duhet të jemi te piramida, që natën të lëvizim në tokën greke.

Ndërkaq, diçka e pakuptueshme më ngacmonte mendimet. Herë një merak më gërryente, herë një kureshti e madhe më pushtonte. Ndihesha një fëmijë që ka marrë vendim të bëjë punë të rriturish dhe për t'ia dalë mbanë kërkon t'i mbushë mendjen vetes se është burrëruar. Kësisoj, hem krenohesha për atë vendim, hem mëdyshesha. Por, kthim pas nuk kishte. Para greminës që



lashë pas ishte parajsja e ëndërruar. E vetmja zgjedhje, e vetmja shpresë.

Në katër pasdite Kapoja dha urdhër të nisemi. Bashkë me Ilian, udhërrëfyesin tjetër të gjatë, thatim dhe kokëkashtë ecnin në krye të kolonës. Ne i ndiqnim pas si dele.

Dielli na binte nga pas e hijet na dilnin përpara me imitimet e përpikta të lëvizjeve tona. Ecnim të heshtur, në kolonë, duke hedhur sytë herë pas herë në drejtim të majës së malit, në shpatet e grykës e përreth, për të vërejtur ndonjë të papritur. Ankthi rrinte zgjuar, me kthetrat gati sapo t'i jepej rasti.

Dhe nuk vonoi. Një zhurmë e mbytur na shtangu befas. Vështruam njëri-tjetrin, pastaj pamë përqark. Po nuk ishte ajo që menduam. Një breshkë që rrëzohej rrokullimthi nga shkëmbi në të djathtë, bëri disa kollotumba e qëndroi para këmbëve të dy udhërrëfyesve.

- Pty, - pështyu Niko Kapoja gjithë zemërim, - na ngriu gjakun!

I futi një shkelm me gjithë forcën kafshëzës së gjorë, që u përplas pas një guri me kërcitje të mbytur. U rikthye dy pëllëmbë pas prej përplasjes e ndaloi me shpinë në tokë, duke tkurrur këmbët brenda zhguallit.

- Ashtu të ngordhësh, - shfryu dufin Nikoja e bëri përpara. Por dikush nga djemtë e ktheu mbarë kafshëzën që vuante.

- Nuk bon, - tha mëshirëmadhi, - o gjynof!

U nisëm sërish për udhë me hapa të matur e me sytë katër. Zhuzhima e bulkthave mbushte ajrin. Gryka e malit të jepte përshtypjen e një fortifikimi, i cili ngjallte edhe

siguri, edhe frikë njëherësh, ngaqë nuk linte mundësi shmangieje në rast përballjeje me patrullat. Ecnim dhe dihatnim nga e përpjeta, nga rruga plot gurë, nga vapa, ndonëse nuk ishte ajo e para. Mbas shpinës, qyteti i vogël, mbetur poshtë, dukej një grusht.

- Jemi në gjysmë të malit, - tha Kapo. - Shpresojmë të mos biem në patrullë.

Kolona zvarritej përpjetës.

Pas pesëmbëdhjetë minutash udhë, një “ndal” buçitës na shtangu në vend. Pamë andej nga erdhi zëri. Mbi një shkëmb si trampolinë, në të djathtë tonë, lartohej si lis një trup i gjelbër nga koka në këmbë. Mbante varur në qafë automatikun me tytën drejt nesh. Askush nuk po reagonte. Ushtari mbi ballkonin shkëmbor buzëqeshte me cinizëm. Mbi gjoks i varej edhe një dylbi, shenjë që tregonte se na kishin vrojtuar herët. Në krah të tij erdhën ndërkaq dy ushtarë të tjerë. Qëndruan edhe ata mbi shkëmb, si mbi pedestal.

- Kujtuat se do na e hidhnit? - foli qesëndisë ai që u shfaq i pari dhe që, me sa dukej, ishte komandanti.

- Jo, ç'është ajo e hedhur! - ia ktheu Kapoja ynë, më i qeti nga të gjithë. - Thjesht duam të kalojmë matanë.

- Është shkelje ligji, të kalosh matanë, nuk e dini? - pyeti me atë cinizmin e parë komandanti i patrullës.

Asnjë nga ne nuk foli.

- Duhet ta dini që dënoheni për këtë shkelje, - i shtoi edhe një dozë presioni cinizmit të vet.

- E dimë, po ç'të bëjmë? - u përgjigj me maturi Niko Kapoja. - Po ikim për punë, të mbajmë shtëpitë, si të tjerët. Ju e dini si është gjendja këtu.

Tjetri rregulloi më mirë automatikun në krah, po nuk e uli tytën që shihte drejt nesh. Të tre rrinin pa lëvizur në atë pozicion të mirëmenduar nga ku zotërohej gjithë hapësira e grykës. Ne i vështronim nga poshtë si ca zogj të uritur, me kokën përpjetë, në pritje të thërrmijave të ushqimit.

- Po, por ne këtu jemi për të zbatuar ligjin, jo për t'ju kuptuar juve, - ia ktheu ai. - Kjo që bëni quhet kalim i jashtëligjshëm i kufirit dhe për këtë dënoheni.

Djersët më mbuluan fytyrën, ca nga vapa, ca nga sikleti. Do të na arrestojnë, mendova i frikur. Më mirë vdekja sesa burgu, pata kohë të arsyejoja: atje me siguri do të çmendesha. Dhe vdekja vështronte disa metra me tutje, ose një e shkrehur këmbëze larg, ashtu si kurrë nuk e kisha menduar. Prisja të thoshte ndonjë fjalë Niko Kapoja. E përpija me shikim fytyrën e tij të vrenjtur, sytë e picërruar, ballin e djersitur e të rrudhur, hundën e drejtë, mjekrën e vogël. Pse nuk thoshte një fjalë? Përse nuk na nxirrte nga kjo situatë? Mirëpo, Kapoja ynë finok dhe gjakftohtë, sikur të ma kishte kuptuar mendimin, ktheu përgjigje pasi fshiu me pëllëmbë djersët e ballit.

- Të gjithë hallexhinj jemi: si ne, si ju. Ne ikim nga varfëria, ju bëni atë që e keni detyrë të bëni. Shqiptarë jemi të gjithë. Ne kemi hallin e grekut, se me atë nuk merresh vesh, të heqin qafe pa një pa dy.

Kapoja i tyre e kuptoi ku donte të dilte ai yni. Vari në sup automatikun, duke ma hequr kështu ndjesinë e vdekjes. Tha prerë:

- Prisni aty!

Të tre zbritën nga shkëmbi trampolinë duke i rënë rreth nga pjesa e sipërme. U vunë përballë nesh.

- Sa keni? - pyeti me sy lakmitarë.

- Ç'na kanë mbetur nga rruga, - foli këtë radhë Ilia, - lekë shqiptare. Më mirë merrini ju, andej ç'na duhen.

Nxori gjashtë mijë e pesëqind lekë nga xhepi e ia zgjati. Ushtari kapo shtrembëroi turinjtë i pakënaqur, por nuk tha gjë. I rراسi në xhep, pastaj u drejtua nga ne.

Djemtë filluan të kruanin xhepat, ndërsa unë kruaja kokën prej sikletit. Nuk kisha asnjë qindarkë. Djemtë dorëzuan ç'kishin e kapoja i patrullës i futi dhe ato në xhep. Pastaj pa nga unë që rrija pa lëvizur.

- Po ti?

Unë mbeta gjuhëlidhur. Më nxori nga sikleti Niko Kapoja.

- Ai është jetim, nuk ka kokërr leku. E morëm me vete se na u lut me të qarë, nuk ka njeri këtej. Na erdhi keq, ç'të bënim? - foli nxitimthi.

Ushtari më hodhi një vështrim përçmues që më drithëroi nga koka në këmbë. Por; trupi i imët dhe fjalët e Kapos ia kishin dalë t'ia mbushnin mendjen.

- Mirë, - tha pasi bëri dy tre hapa mbrapa, - shkoni! Dhe kini kujdes, - porositi më pas, - mos iu ndani kësaj gryke, se ngatërroni rrugë e hasni në patrullën tjetër. Nuk janë të gjithë si ne. Hajt, ju vaftë mbarë!

Ata humbën andej nga dhe u shfaqën papritur, ne vazhduam në udhën tonë.

Në përfundim të diellit mbërritëm në kufi. Qe një muzg i freskët në majë të malit. Ajri të shqyente mushkëritë,

qielli aq afër sa kurrë ndonjëherë, hapësira e pakufi gjithandej.

- Kjo është piramida, - tha Ilia dhe tregoi me dorë një si muranë.

U mblodhëm rreth saj kureshtarë. Vështroja atë copë betoni me njëfarë zhgënjimi. E kisha përfytyruar diçka gjigante, hijerëndë, si një lloj sfinksi që nuk të hap rrugë. Dhe ja, më shfaqej kaq e mjerë në atë majë mali, si fosil i një kohe të largët, pa asnjë vlerë, për të cilin askush nuk donte t'ia dinte më. Nuk di pse më shëmbëlleu me një fëmijë fatkeq.

- Këtu ndahet toka jonë nga ajo e grekut, - më nxori nga mendimet zëri i Niko Kapos. - Klonin me tela me gjemba e hoqën sapo ra regjimi.

“Domethënë, tani do të kalojmë kufirin, do të arratisemi, me një fjalë”. Kështu mendova dhe një drithërimë më përshkoi trupin. Akt tradhtie do të quhej dikur dhe përjetë do të më ndiqte mallkimi. Por, tani, dukej kaq e pakuptimtë kjo gjë dhe kaq i thjeshtë kalimi i kufirit. Më oshtiu në vesh sikur ta kisha aty, zëri i lulishtarit lab të shtëpisë së fëmijës, xha Likos, i vrazhdë, i plotë, buçitës, që i bashkohej shprehjes krenare dhe plot entuziazëm të fytyrës së eshkët, si një zhguall lisi. Të thoshe lab për të ishte si të thoshe sulltan, mbret a ku e di unë ç'tjetër, aq shumë ishte i dashuruar me origjinën e tij. Imazhi i tij epik m'u shfaq në krah të piramidës së vogël suvarënë, duke kënduar me patos këngën e tij të parapëlqyer:

*Dhe një natë o nëna ime,  
kur shërbeja, në patrullë,  
bashkë me shokët që pata,  
dy armiq të gjallë i zumë.*

Ndoshta ishte ky vendi ku u ngjiz ajo këngë, mendova, ku i dihet. Edhe këtu mund të ketë pasur shkelje kufiri, siç thuhej në atë këngë. Mund të jenë ndeshur ikanakët e nëmur me qëndresëtarët e lëvduar, ku çdonjëra palë pretendonte të drejtën e vetes dhe damkoste palën tjetër. Dëshmitare për të gjitha këto ishte kjo piramidë kaq e mjerë dhe e braktisur.

Mundohesha të përfytyroja se si ishin ndier të ikurit e dikurshëm teksa hidhnin hapat e fundit në tokën e tyre. Ç'kishin përjetuar sapo kishin shkelur në tokën e huaj? Ç'brengë kishin marrë me vete, ç'amanet kishin lënë pas e ç'i kishte pritur matanë klonit me tela me gjemba? Doemos e kishin ditur se që atë minute i kishin quajtur tradhtarë dhe armiq të popullit...

- Hajde, nuk kemi kohë për të humbur! - më nxori nga meditimimi zëri i Ilias.

Në nxit e sipër kaluam në anën tjetër të kufirit, pa asnjë damkosje dhe nëmë, veç me merakun e asaj që vinte pas.

Ecnim rrugë pa rrugë nëpër barin e lartë, pengoheshim nëpër gurët që fshiheshin nën të, ngatërroheshim nëpër bimë ferracake, por nuk ndalnim; duhej të arrinim sa më parë në pyll.

Nata na zuri në një lëndinë të vogël mes pishave të larta. Drita e hënës mezi depërtonte deri poshtë nën degët.

Ajri ishte mjaft i freskët, ndaj u veshëm më trashë dhe u rehatuam si na e mori mendja. U struka te trangu i një pishë, mbledhur kokë e këmbë kutullaç. Isha i kapitur. Qepallat m'u mbyllën menjëherë.

Mbas një kohë që nuk e përcaktoja dot, më zgjoi një goditje e lehtë në mollaqe. Dikush foli me zë të ulët: çohu, or çun, duhet të ecim sa ka ende natë. U ngrita përtueshëm dhe iu qepa pas. Grupi që bërë gati, me trastat mbi shpinë. Nata që ende e plotë kur u nisëm sërish.

Ecnim të heshtur në një udhë kafshësh që na doli përpara. Diku hasëm ndanë rrugës një stivë të madhe drush, gati shtatë metra të gjatë dhe e ngritur pak më shumë se një metër.

- Do të ketë njerëz afër, - tha Ilia. - Ndoshta s'kanë nisur akoma punë, por duhet të jenë këtej rrotull. Duhet të ecim sa më shpejt, të dalim nga pylli e të marrim monopatin përgjatë lumit.

Fliste në ecje e sipër. Ne shkonim mbas tij, duke shkëmbyer ndonjë fjalë ose më mirë të thuash duke mërmëritur.

Befas, Nikoja ndali duke hapur krahët anash. Pas tij ndalëm të gjithë. Ca zhurma si hapa kafshësh vinin duke u afruar. Pastaj ca fjalë që nuk kuptoheshin mirë në ç'gjuhë ishin. Shikonim nga Nikoja dhe Ilia, që prinin kolonën, për të kuptuar se ç'mund të bënim. Por, ata përgjonin gjakftohtë. Te kthesa që kishim përpara u shquan siluetat e disa kalorësve. Bisedonin e qeshnin me të madhe. "Pa merak", - na qetësoi Ilia dhe vazhdoi rrugën. Kafshët ndalën, kur u gjendën përballë nesh. Ishin ca mushka

të larta, të forta, që u ndriste qimja si të qenë lyer me xhelatinë, të tria me një ngjyrë kafe të çelur e pulla të bardha vende - vende. Burrat përmbi to duhet të ishin nga tridhjetë deri në pesëdhjetë vjeç, të shëndetshëm, me mustaqe të trasha e të zgjatura anash, si malësorët tanë, por ezmerë. Dukeshin qartazi që ishin arixhinj. Fare të qetë, ngjatjetuan në greqisht. Po në greqisht ua kthyen udhërrëfyesit tanë. Burrat nuk u zbritën mushkave, por dukeshin paqësorë ngaqë, pa dyshim, e kishin kuptuar se kishin të bënin me refugjatë. Biseduan për pak minuta në greqisht me Nikon dhe Ilian, u ngjatjetuan sërish me ne dhe u folën mushkave.

- Do të bëjmë djathtas, - tha Nikoja, - thanë që duhet të ecim këtej lumit, jo matanë, ku duket fshati. Në anën tjetër do të hidhemi te ura, për të dalë në rrugën me asfalt. Duhet të bëjmë kujdes, thanë, sepse zona rrihet shumë nga ushtarët dhe asfalia, ngaqë këtej kalojnë shumë refugjatë.

Pylli zbriste deri në breg të lumit, ku gjendej një lëndinë, në cep të së cilës qe një çezmë e ulët, gati rrafsh me tokën, me një sylynjar nga ky derdhej një curril sikur zihej raki.

- Hamë këtu mëngjes, - tha Nikoja, - se nuk i dihet si shkon puna më pas.

Si mbaruam së ngrëni, sikush nga trasta e vet, ndërsa unë pak nga ushqimi i Nikos e Ilias, që ma afruan me bujari, u shtrimë të pushonim. Dielli ngrohte më shumë tani, ndaj u këndellëm si kotelet pranë zjarrit. Duhaxhinjtë e ndezën nga një cigare.

- Agim, - m'u drejtua Nikoja, - duhet të gjesh një emër grek për veten. Jorgo, për shembull. Ose Kristo.



Kristo është më i bukur, më i pranueshëm. Me këtë emër të marrin me sy të mirë kudo që të biesh. Tani e tutje je Kristo!

Ilia qeshi. Unë nuk fola, mbeta si hu, pa ditur ç'të thosha. Thashë vetëm "mirë", pa i kuptuar të mirat që do më vinin nga emri i ri. Edhe të tjerë nisën të qeshnin. M'u duk se po talleshin me mua, por nuk flisja. Pastaj Nikoja u ngrit, mbushi një bidon plastik të boshatisur te currili i ujit, u afrua tek unë dhe ma hodhi në kokë. Uji i ftohtë më futi dridhmat e unë munda vetëm të them një "mos!" U shkunda si rosat kur dalin nga pellgjet, ndërsa ata vazhdonin të qeshnin. Të qeshurat e tyre më futnin dridhmat më shumë se akullsia e ujit. Kuturisjet më kumbonin të hidhura, ironike. Rrija dhe vështroja me gojën hapur, i çuditur nga ky veprim i papritur. Ç'patën? - pyeta veten. Gjithë rrugës ishin sjellë mirë me mua. Një frikë e pashpjeguar më kapi, veç nuk mund të bëja ndonjë veprim kundërshtues, përderisa ende nuk ua kisha kuptuar qëllimin. Ilia m'u afrua duke qeshur, më zuri nga supi dhe tha:

- Ky është nuni yt, të ka vënë emrin, të pagëzoi.

E vështroja i hutuar Ilian e thatë, me sy të vegjël picërues, por nuk shihja ndonjë qëllim të keq në fytyrën e qeshur. Edhe të tjerët dukeshin pa djallëzi, pa ndonjë të keq në këtë punë. Nuk kuptoja ç'do të thoshte pagëzim e as dija ç'ishte nuni. Gjithsesi, u shkunda sërish, më tepër për të hequr hutimin sesa ujin e ftohtë, të cilin e kishin pirë teshat më së shumti.

- Di ç'është pagëzimi? - pyeti Nikoja, pasi e pa që nuk po dilja nga ajo vorbull paqartësie.

- Jo, - u përgjigja menjëherë me kureshtjen kryengritur.  
- Aha, ndaj rri si guhak, - tha.  
- Këtu të gjithë njerëzit duhet të pagëzohen, - vazhdoi.  
- Edhe ti duhet të pagëzohesh patjetër, të të marrin me sy të mirë, ndryshe të shohin vëngër, si qen të zgjebosur. Janë të fiksuar pas fesë. Edhe emrin ndaj të thashë ta ndërrosh, nuk mund të pagëzohesh me këtë emër që ke, Agim! - përfundoi duke përveshur buzët përçmueshëm.

Ndaloi pak, hoqi thellë duhanin, mbushi plot mushkëritë, e nxori tymin sikur shfrynte një marmitë makine, e hodhi cungun e cigares tutje e m'u kthye përsëri.

- Tani, dëgjo! Ja ç'është pagëzimi: Kur dikush do të bëhet i krishterë shkon të pagëzohet te prifti, në kishë. Prifti të spërkat me ujë të bekuar, ose të hedh ujë të bekuar në kokë, siç të hodha unë tani, për të larë mëkatet dhe për t'u bërë një i krishterë i pastër, pa mëkate. Fëmijët e vegjël i zhytin në një kazan me ujë të bekuar. Pagëzimi vulozet me thënien e priftit: Të pagëzohesh në emër të atit, të birit dhe të shpirtit të shenjtë, amin! Dhe kështu bëhesh i krishterë. E more vesh?

Bëra po me kokë i qetësuar. Ja ç'na paskëshin qenë veprimet e tyre aq të çuditshme pak më parë! Paskësh pasur një kuptim të madh gjithë ajo lojë, të cilën e mora për tallje dhe u mërzita aq shumë, por pa e dhënë veten, sigurisht.

- Punën e priftit e bëra unë, kështu që; në emër të atit, të birit e të shpirtit të shenjtë, të shpall të krishterë, o Krist! - m'u drejtua pastaj, ndërkohë që të tjerët ia

plasën së qeshurës, por kësaj radhe të qeshurës së tyre iu bashkova edhe unë.

- Ta gëzosh emrin! Më ke nun e do më kesh krah për gjithçka, Kristos mu! - përfundoi Nikoja duke më përqaftuar.

Ende rrija nën dalldi. Nuk dija nëse duhej ta merrja me gjithë mend këtë gjest, këtë akt të kryer apo kjo skenë që vetëm një shaka. Gjithsesi isha i qetë. Kisha kohë pa u ndier kaq i gëzuar, pa qeshur kështu, së bashku me një grup njerëzish. As më ishte gjendur kush me një përkrahje të tillë, si kjo që më jepte nuni, edhe pse as atë nuk e dija ç'ishte, por kuptova se do të ishte diçka e mirë të kisha një nun, që do të më bëhej krah për gjithçka.

Hareja na kishte hyrë në shpirt, gati kishim harruar ku ndodheshim dhe përse. Shtrirë në lëndinë pas lodhjes nga rruga e gjatë, prehja ngërthyese erdhi plot ëmbëlsi. Tek shullëheshim shpenguar, një nga djemtë që thithte cigaren me etje dhe e nxirrte shtëllungë, duke e shfryrë përpjetë qiellit, pasi bëri një thithje të thellë dhe një shfryrje të fortë, tha:

- Nunit mos iu nda, ka detyrime për ty! - dhe vështroi nga Niko Kapoja. Qeshte me hee hee hee hee të zgjatura dhe përsëri i futi një të thëthirë të thellë duhanit. Qeshja edhe unë si gallof ngaqë nuk merrja vesh nga ato që thoshte. Pasi i shfryu fort sërish tymit përpjetë, me sy të habitur m'u drejtua:

- Apo as nunin nuk e di ç'është?

U ndjeva pak ngushtë kësaj radhe, sepse më erdhi turp të isha kaq i paditur, por përsëri u përgjigja me çiltërsinë më të madhe dhe me kureshti njëherësh.

- Jo, nuk e di!

- Nuk ke faj, - tha këtë herë me një lloj dashamirësie.

Nuk qeshi askush e as tha ndonjë fjalë shpotitëse. Djali që tymoste bëri edhe njëherë thithjen dhe shfryrjen e tymit të duhanit, gjersa cigarja sosi dhe e flaku. Pastaj, duke i lëvizur ato sytë e vegjël dhe të shkathët si prej maçoku sa nga unë, sa nga Nikoja, sa nga Ilia, tha:

- Nun quhet ai që të vë emrin, këtë të krishterin, Kristin, dhe e ka për detyrë të kujdeset për ty gjithmonë. Si fillim duhet të të blejë ca rroba, një palë këpucë, një palë çorape e një kryq floriri, ta varësh në qafë.

Qeshi sërish me hee hee hee të zgjatura. Vështronte cinik Niko Kapon, i cili kishte shkuar te sylinjari ku rridhte currili i ujit sikur ziejë raki, të mbushte bidonin e boshatisur nga pagëzimi im. Kapoja vuri buzën në gaz, më shkeli syrin me kuptim.

- Të tëra do t'i bëj, mos ki merak, *sig-siga*<sup>1</sup> bëhen punët e mira, vetëm të kemi kësmet dhe të na vejë mbarë, - tha dhe shkoi te trasta e tij, futi bidonin me ujë brenda, rasi edhe ca rraqe që i kishte nxjerrë kur u rehatuam, i mbylli grykën, e hodhi në shpinë e urdhëroi:

- Tani ngrehuni! Do nisemi!

Për pak sekonda u bëmë gati. Po me urdhër të tij u ndamë në dy grupe, të mos binim në sy gjatë lëvizjes.

- Ti, Krist, do të vish me mua, se jam nuni yt, - m'u drejtua e u shkeli syrin të tjerëve. - Do të mbajmë një farë

---

<sup>1</sup> Gr. - Ngadalë-ngadalë.

largësie grupi nga grupi, me qëllim që, edhe nëse njëri grup ndeshet me policinë, të shpëtojë tjetri. Kështu nuk do të biem të gjithë viktimë, të shpëtojë kush të mundet.

- Ne po shkojmë përpara, ju na ndiqni! - i tha Ilias.

- Si të kalojmë urën, do hidhemi matanë asfaltit e do të ecim përkrah rrugës automobilistike, përmes shkurreve, jo në të, deri në një vend tjetër më të sigurt. *Endaksi?*<sup>1</sup>

Ne pohuam gatishmërinë me të tundur të kokës.

- Nisemi, atëherë!

Si u larguam rreth njëqind metra nga vendi i nisjes, Nikoja ua bëri me dorë grupit tjetër të nisëj. Urën e kaluam nxitimthi, pasi aty ishim më zbuluar se kudo tjetër. Disa sekonda na u deshën të zinim vend mes shkurreve përmbi xhade, nga ku vëzhgonim lëvizjet e grupit tjetër. E, ndërsa ata ishin duke kaluar me ngut urën, u shfaq papritur, në kthesën pak më tej, një makinë e gjelbër, e vogël, sa një brumbull, me një antenë të gjatë si rrufepritëse mbi kabinë. Ata nuk shihnin gjë në atë pozicion të ulët që ishte ura. Donim t'i lajmëronim, por si? Si t'u bënim shenjë të ktheheshin prapësht, të fshiheshin diku, sepse me siguri makina do të ishte nisur për në fshat. As na shihnin t'u bënim ndonjë shenjë dhe as nuk mund të bërtisnim. Makina shquhej edhe më mirë ndërsa afrohej. Ishte në ngjyrë të gjelbër me pulla bezhë, lara - lara. Antena e gjatë përkulej nga pas, ndërsa xhamat e dritareve ishin të hapura. Brenda saj dallonim katër vetë

---

<sup>1</sup> Gr. – Në rregull?

me uniformë ushtarake. Djemtë e grupit tjetër nxitonin mbi urë, makina brumbull lëvizte mbi asfalt. Dukej sikur kishin vënë bast të takoheshin te cepi i urës, në vendin më të papërshtatshëm për t'ia mbathur apo për t'u fshehur në rast ndjekjeje. Një fiqe shprese na bënte të mendonim se nuk do të shkonin si çjapi te kasapi. Vështronim gjithë ankth lëvizjet e të dyja palëve. Ndoshta, njëra prej tyre do të gabonte në kohë për të mos u takuar së bashku. Por, jo! Ndodhi saktësisht ajo që nuk duhej të ndodhte. Ata dhe makina brumbull mbërritën te cepi i urës në të njëjtën kohë.

Një frenim i fortë u dëgjua mbi asfalt. Katër ushtarakët, dy prej të cilëve kishin në duar revolverë, dolën vrik nga makina dhe u sulën drejt djemve që ngrinë në vend. Ne këtej rrugës, strukur në shkurret e harlisura, patëm ngrirë njësoj si ata. Ushtarët diç biseduan nervozë me Ilian dhe pas pak u lidhën duart me ca shirita e i futën në makinë, nga porta e pasme. Makina u nis andej nga erdhi. Antena si rrufepritëse u lëkund lehtë disa herë dhe pasi makina mori shpejtësinë e njëtrajtshme, u përkul nga pas si një gjuhë nepërke. Dukej sikur thoshte: “Edhe ju nuk e keni të gjatë”. E ndoqëm me sy derisa humbi në kthesën nga ku ishte shfaqur pak më parë. Pastaj vështruam njëritjetrin pa ditur ç'të thoshim.

Një mijë mendime të liga më erdhën rrotull në kokë atë çast. Aventura në këtë vend të huaj po më dukej e rrezikshme. Me padurim prisja të thoshte diçka Nikoja, të mësoja si do të vepronim, si do të vinte halli ynë. Dhe ai foli, duke sharë me zemërim ushtarët grekë.

- Kurvat, sikur mbinë nga dheu!

Pastaj hodhi një sy rreth e rrotull zonës, për të kuptuar më mirë situatën. Në fund tha i vendosur:

- Ky qe fati i tyre, nuk kemi ç'bëjmë! Të ecim sa të mundim, të largohemi sa më shumë prej këtej.

Kostë Kondi lëvizi në kolltuk. Një shprehje të papërcaktuar kishte në fytyrë. Djali kërkoi të kuptonte ndonjë mendim të tij, por në ballin e gjerë e të lëmuar dukej se kishte zënë vend misteri. Prifti u ngrit në këmbë dhe eci në drejtim të dritares. Djali nuk e kuptoi se ç'gjë e bëri të lëvizte nga vendi dhe të afrohej te dritarja me pamjen nga lumi, prej ku shihej ura. Prifti vështronte jashtë, ndërsa ai shpinën e priftit. Iu duk më i kërrusur, supet të rënë. Nuk e kishte vënë kamillafin dhe flokët i vareshin pas si degë shelgu. Tej dritares, gjethet e bajames lodronin nga një puhizë e lehtë nën diellin e plotë, duke krijuar dritë - hije të lëvizshme. Heshtja zotëronte dhomën. Djali nuk guxonte ta prishte këtë heshtje, aq më shumë nuk guxonte ta ndërpriste priftin nga ai përqendrim, vetëm se ishte mjaft kureshtar të dinte ç'mendonte.

- Ajo urë është ndërtuar nga im atë, - foli papritur prifti pasi u kthye nga ai.

Djali e pa me një lloj fajësie për mosdijen. Sytë e priftit kishin marrë një ngjyrë të errët, si qiej të sapombuluar nga retë. Bëri kryqin e belbëzoi diçka që djali nuk e kuptoi nëse ishte lutje a diçka tjetër. Iu vodh shikimit të tij. U ul në kolltuk, u rehatua duke shtrirë krahët në të dy mbajtëset anësore, kreu me dorë mjekrën e thinjur vija-vija e tha:

- Është ndërtuar nga im atë, pesëdhjetë vjet më parë.

Fjala sikur i ngeci. Djali mendoi se diçka më tepër donte të thoshte, por e preu mendimin si me shpatë. Mbas një pushimi, gjatë së cilës kreu përsëri mjekrën me duar më shumë se zakonisht, vazhdoi:

- Përtej ishin pronat tona dhe lumi në dimër bëhet i egër. Ajo urë ka shpëtuar shumë njerëz në kohën e luftës, kur iknin në Vorio Epir.

Prifti nxori një psherëtimë, ndërsa djali nuk foli, vështronte se si lodronin në dritare lulet e bajames. Donte të fliste, por tani e preu ai mendimin në mes, për të mos thënë ato që i erdhën për të thënë. Sepse e dinte që prifti do të mërzitej, si para do kohësh, kur qe duke i folur për krishterimin me patos dhe pasion. Atëherë i pati thënë se vorioepiriotët duhet të ngrenë zërin e të shpallin ndershmërisht se janë helenë, me krenari dhe kurajë. Mirëpo, ai, me aq sa kishte mësuar në shkollë dhe ashtu si pohonin të gjithë në Shqipëri, ia ktheu me naivitet fëmije se Vorio Epiri nuk ekzistonte. Iu kujtua se si prifti i mblodhi vetullat mbi ballin e gjerë, se si i lëvizte pareshtur një muskul në cepin e syrit të majtë, se si u ngrys dhe u turbullua dhe se si iu drodh mjekra e hirtë, thinjur vija-vija, lëshuar përmbi gjoks si një ujëvarë e ngrirë. Ia hodhi menjëherë poshtë dijet e pavërteta, sipas tij, duke i thënë se një shtet ateist nuk mund t'u mësonte kurrë shtetasve të tij të vërtetën.

- Duhet t'i harrosh të gjitha ato që ke në kokë, biri im, - vazhdoi ta këshillonte. - Një i krishterë i mirë duhet të çlirohet nga e pavërteta, duhet të ndriçojë mendjen dhe



duhet të dijë të jetë mirënjohës për çka Zoti i ka dhuruar. Të jesh një i krishterë është detyrim i madh ndaj Zotit, por të jesh një i krishterë helen është dhuratë nga vetë Zoti. Pranoje me bindje dhe mirënjohje këtë dhuratë dhe bëhu krenar për të!

Duke pasur parasysh këtë gjë djali u tulat, por nuk i bëhej të pohonte atë që tha prifti, as të thoshte gjë. E mbylli gojën dhe i shtypi mendimet të mos dilnin në dritë. Nuk mund t'ia lejonte vetes të gabonte dy herë me papun që e kishte rrëmbyer si një zogth prej vdekjes dhe e kishte rikthyer në jetë. Nuk kishte as fuqi të përballonte sërish zemërimin e tij e të dëgjonte leksionet e gjata pasionante. Ndaj e pa të udhës të priste e të dëgjonte çfarë do të thoshte. Por, prifti e këputi këtu atë fill bisede, pasi parapëlqeu të ndiqte fillin e historisë së djalit.

- Po pastaj, si vajti puna? - e nxiti sërish.

Ecnim me lepurin në bark përmes shkurreve, rrugë pa rrugë, të mos binim në sy. Kujtonim fjalët e arixhinjve sharrëxhinj për të bërë kujdes e sytë i bënim katër. Dielli na rrinte si saç mbi kokë, djersët na shkonin çurg. Ankthi i së papriturës përgjonte çdo çast. Diku qëndruam për të mbledhur pak veten. Përreth qetësi, dëgjohej vetëm kënga e cinxrave. Niko Kapoja fshiu me pëllëmbë djersët mbi ballë, hodhi sytë rreth e rrotull për t'u siguruar nga ndonjë rrezik.

- Dëgjoni! - tha. - Mund të na bëjë vaki edhe ne ajo që u ndodhi atyre. Nëse ndodh, bëjini derman kokës. Mbathjani, fshihuni, zhdukuni nga sytë këmbët, nëse do të keni mundësi. O Mete për vete, thoshte im atë. Por mos e vini veten në rrezik. Po qe se nuk keni rrethana për t'ia mbathur, bëni siç bënë ata; dorëzohuni, pa llafe, pa i mërzhitur, se pastaj nuk dihet ç'u thotë mendja dhe e kanë merak vetë ata.

Fjalët e Nikos ma shtuan frikën. Doja të mendoja si mund të reagoja në ndonjë rast të tillë, por Nikoja nuk la kohë.

- Nisemi, - tha dhe priu. - Kujdes mos shkelni ndonjë gjarpër, - shtoi, - në vapë dalin për ujë e pickojnë. Të keqen e grekut pastaj!

Tani vigjilonim me ankth dyfish: për patrullat dhe gjarpërinjtë. Pas disa minutash rrugëtim shtegu na nxori përsëri në rrugën nacionale, një kthesë djathtas. Nikoja kontrolloi rrugën në të dy anët.

- Do kalojmë një e nga një, - tha, - po me të shpejtë ama! Do të futemi përsëri në shkurret matanë rrugës. Do ecim përgjatë lumit sa të largohemi nga kjo zonë.

Vështroi edhe njëherë majtas e djathtas dhe kërcëu në asfalt. Ia dha vrapit e humbi mes bimësisë së gjelbër. Ne rrinim ende të strukur. Asgjë nuk pipëtinte. Dikush që e thërrisnin Vangjo foli zëulët.

- Po hidhem unë! Sapo të futem mes shkurreve, nisuni edhe ju! Takohemi matanë!

U hodh me shpejtësi e humbi mes shkurrishtave si Nikoja. Aksioni i suksesshëm i tij më dha njëfarë sigurie. Edhe të tjerët dukeshin të qetë. Thanë pa u vonuar: Po hidhemi! dhe u hodhën mbi asfalt njëherësh. Unë nuk munda të hidhesha me ta, s'e kuptova pse. Ndoshta u hutova nga veprimi i beftë i tyre e kështu, mbeta i vetëm këtej rrugës, nën një ndjenjë braktisjeje që m'u zgjua vrik. Megjithatë, kërkoi t'i jepja kurajë vetes.

- Ja, - arsyetoja, - sa të hidhen përtej, të zënë një vend të fshehtë e do të më presin atje.

Në të vërtetë, isha bërë një grusht nga frika. Nuk e dija në do të isha i zoti të bëja atë që bënë ata. Përpiqesha të mblidhja veten, që sapo ata të hynin mes shkurresh matanë, unë hop...

Por, se nga erdhi një zhurmë si fërshëllimë a si uturimë e unë u bëra jo sa një grusht, po sa një gisht, sa një gisht i vogël, gishtëz, më i vogël sa ai Gishtoja i përrallës që zysh Esmaja na i tregonte në orën e letërsisë, me zërin e trashë nga duhani, që më shumë na fuste tmerrin sesa na argëtonte. Dhe u bëra njësh me tokën, dhe s'po merrja frymë fare, dhe zemra po më rrihte aq fort sa frikesha mos m'i dëgjonin goditjet e saj. Dhe s'bëzaja. Nuk shihja asgjë nga aty ku isha struktur, përveç majës së një antene si të atij brumbullit lara - lara që kishte marrë pak më parë shokët e grupit tjetër, e cila shkonte sa andej këndeje, sikur përgjonte strofullin tim. Dëgjova të bërtitura "stamata, stamata" dhe pastaj ca fjalë të tjera që nuk i kuptoja, dyert që u përplasën me forcë, një zhurmë përsëri si fishkëllimë a si uturimë, pashë majën e antenës që u përkul nga pas, sikur më thoshte "do të të gjejmë, s'ke ku shkon" dhe më pas heshtje. Heshtje që e nanuritnin me zell të madh cinxrat.

Nuk guxoja të lëvizja. Më trembte heshtja dhe kënga e hareshme e atyre insekteve të padukshëm sikur gëzonin vetminë time, vetmi që m'u bë makth dhe më pushtoi të gjithin. Një mijë e një skenarë kisha menduar gjatë udhës. Që mund të binim në ndonjë humnerë e të thyenim ndonjë këmbë a dorë, ose edhe kokën; mund të na sulmonte ndonjë ujk ose ari në mal, mund të na qëllonin e të vriteshim mes pyllit pa e marrë vesh njeri, të na rrihnin a të na poshtëronin, - si ato ngjarjet që tregonin djemtë gjatë rrugës - të na fusnin në burg, të na torturonin... Po që do të mbetesh papritur i vetmuar, struktur në shkurret

si një hardhucë e mjerë, nën diellin që piqte si saç, nuk e kisha menduar. Nga t'ia mbaja? Nuk kisha asnjë ide në kokë se si duhej të veproja. Vetja m'u duk një hiç. Dhe gjithçka m'u përmbloodh në një hiç të frikshëm dhe të kobshëm. Po më tmerronte mendimi se isha një i humbur pa nam e nishan diku në një cep të botës.

Nuk e di sa ndenja pa guxuar të lëvizja nga ajo strofull. Ndoshta do të rrija gjatë sikur mos kisha dëgjuar një fëshfërimë aty pranë, që më trembi aq shumë sa gati më ra të fikët. Kërceva vrik më këmbë. Fillimisht, kujtova se do të ishte ndonjë gjarpër, të cilët edhe t'i mendoja tmerrohesha, por pashë një hardhucë që nxitoi dhe humbi duke e dredhur trupin nëpër shkurre. M'u desh një farë kohë të mblidhja veten e të futja në punë mendimet. Duhej bërë diçka, patjetër! Nuk mund të rrija aty dhe të prisja.

Me drojë zgjata kokën përmbi shkurret. Rrotullova shikimin nga të gjitha anët. Përreth bënte karshillëk një gjelbërim i paanë. Hiçi brenda meje sikur u zbeh nga ky gjallim i natyrës. Vështroja rreth e rrotull si i mbyturi në mes të detit që kërkon një gomë shpëtimi. Nga pas, prej andej nga kishim ardhur, në një si kodrinë në faqen e malit, ndrinte nga bardhësia një ndërtesë me një si kullë në krahun e djathtë. Mendja m'u hap, zemra i uli të rrahurat, qetësia u kthye dhe shpresa u zgjua. Atje do të shkoj, thashë. Aty do të jetë fshati. Logjika filloi të punojë si një motor i riparuar rishtas. Nuk isha kriminel, as hajdut, as njeri i keq nuk isha, ndaj s'kisha pse të kisha frikë. Të paktën nuk do të më linin të vdisja urie ose të më

shqyente ndonjë egërsirë. Më mirë në dorë të tyre se në atë të ushtarëve. Ata më futnin frikën sa herë i mendoja.

Kështu e vendosa. U ktheva mbrapsht, duke shkëlur nëpër gjurmët nga ku kishim ardhur. Le të bëhet ç'të bëhet, i jepja zemër vetes duke ecur. Mendoja vetëm si e si të dilja sa më parë tek ura. Shkurret më fërkoreshin nëpër trupin e djersitur, të gërvishturat më digjnin, frikën e gjarpërinjve e mbytja duke shtrënguar dhëmbët.

Më në fund ia dola. Një copëz lëndinë në të majtë të rrugës që ngjitej në fshat, përmbi urën, më ftoi në prehje nën një rrap të lartë, krahështrirë e gjethegjërë që ndodhej mu në mes të saj. Paska shpëtim, thashë me vete dhe u shtriva nën hije i kapitur. Mora frymë thellë, i kënaqur që fati nuk më nxori përpara ndonjë zvarranik a patrullë, por këtë lëndinë si një parajsë pas një sflitjeje të gjatë. Trupi gjeti paqe, kapakët e syve nuk pritën gjatë po u rrëzuan, vapa mbeti sipër kurorës së madhe të pemës e bota e tërë u rrotullua si një karusel gjigant derisa dielli u shua.

Kur hapa sytë që plotësisht errësirë. Kërceva pupthi i llaftaruar, vështroja rreth e rrotull pa kuptuar ku gjendesha dhe as pse dielli ishte shuar. Makthi u rikthye në zgafellet e trurit. Errësira shponte në sy. I fërkova dhe i shqeva sa munda, si ta pija me sy errësirën. Dalëngadalë terri u zbut. Po shquaja një trung peme aty pranë, viset më tutje, konturet e malit përballë... Në shpatin që nxinte, një dritëz fekste si xixëllonjë.

Pty, shfryva me inat, pty, drej, pty të dhjefsha racën, pty të bëfsha nënën, shava ashtu si nuk e kisha zakon. Shava gjumin, që më këputi menjëherë dhe më doli tani,

kur nata kishte pushtuar vendin; shava natën, që nxinte si lugat; shava veten, për aventurën e marrë në këtë vend të huaj dhe të frikshëm; shava fatin që më la në mes të rrugës përsëri, vetëm dhe pa asnjë mundësi orientimi. Por drita si xixëllonjë atje tej në shpatin që nxinte më joshte me shpresën e farit në bregun e detit. Dhe vendosa: Aty do të shkoj! Aty do të jetë fshati!

Djali ndaloi së rrëfyeri, vështroi sërish priftin. Deri më atëherë rrëfente me sytë në dysheme. Ndonjëherë i hidhte mbi ikonën në mur e, ndonjëherë tjetër, jashtë xhamit të dritares, atje ku lëkundej lozonjare nga fladi dega e bajames. Ngriti edhe prifti sytë e fiksuar në një pikë të dyshemesë teksa dëgjonte me vëmendje. Fytyra e tij qe e paqtë, madje, më shumë se e paqtë, qe e dhembshur. Sytë i shkëlqenin nga një gëzim i brendshëm, vetullat i qenë ngritur lart, duke i marrë territor ballit të ngucur mes tyre dhe flokëve lëshuar mbrapa si lastarë shelgjesh. Buzëqeshi. Djali e vështronte dashamirësisht. Dhe kishte të drejtë; ishte njeriu që e kishte risjellë në jetë. Këtu, te kjo kishëz, ai dhe Perëndia u panë ballë për ballë.

Kostë Kondi u ngrit në këmbë me buzëqeshjen si dritëz e fshehur, që e ndriçonte brenda lëkurës. Krahët i mbante kryqëzuar mbi gjoks. Me hap të ngadaltë iu qas djalit, sytë e të cilit ndrinin sikur po i qasej vetë Jezu Krishti.

- Dhe erdhe, - tha prifti, - erdhe, o njeri i Perëndisë, atë mëngjes të bekuar. Vesa ende nuk qe tretur dhe dielli ende nuk kishte spërkatur me dritë botën. Ishe mbështjellë si një iriq, ja kaq, sa një grusht, te hyrja e kishës, nën vidhin e madh, mbështetur pas trungut, për t'u mbrojtur sadopak nga e ftohta. Dukeshë më shumë një top leckash sesa njeri. Dridheshe nga të ftohtët, sepse nata këtej është e freskët brenda mureve të shtëpisë, në shtroje e jo më jashtë, dhe jo më në këtë vend malor si ky dhe jo më pa një shtrojë poshtë e pa një velenxë sipër, ashtu si të gjeta unë. Mund të kisha ikur pa të parë, pa ia hedhur sytë atij cepi të rrugës e pastaj, kur të të gjenim aty mbas kushedi kur... o Perëndi! Jo, nuk ma nxë goja ta them. Po deshi i Madhi Zot, lëvduar qoftë dhe m'i ktheu sytë aty rrëzë trungut të pishës dhe bëri mrekullinë. U shtanga prej atij topthi leckash si një bohçe e vjetër e braktisur. Iu afrova me dyshim në ishte njeri apo send i flakur, i erdha rrotull, e vështroja me sy të çapëlyer, me zemër të ngrirë. Dhe u tmerrova. Ishte njeri. Pashë duart e brishta mbledhur kryq nën vete, këmbët e gjakosura, po ashtu



mbledhur nën bark, surrati ngjeshur pas gjoksit, bërë një me të. Vetëm flokët shpupuriteshin nga era. Të mora ndër duar. Dridheshe, biri im. Dhe nuk i hapje sytë. Ishe i kallkanosur, në kllapi, gjysmë i gjallë e gjysmë i vdekur. Oh, sa më theri mu në zemër! O Zot, u luta, jepi këtij të mjeri, këtij robit tënd mëshirën tënde dhe lëre të jetojë! Duket kaq i pafajshëm. Dhe mendova se Zoti nuk kishte nevojë për lutje të tjera, ngaqë e kishte sjellë mu te dera e kishës, në shtëpinë e vet robin e tij. E kishte sjellë të mos mbetej i braktisur, i vuajtur, i mjerë, po të shihte dhe të merrte jetë nga hiri i Zotit, nga drita e tij. Dhe nxitova, biri im, nxitova të vija në vend urdhrin e Perëndisë.

Djali e ndiqte me gojën hapur, gjithë sy e veshë. Ngazëllimi i mbushte gjoksin. Prifti iu avit buzëqeshur, i qëndroi përballë, i nduku faqen e butë, të njomë, gati qumështor, ia fërkoji me pëllëmbën e tij të kadifenjtë dytri herë. Pastaj ia kapi kokën mes dy pëllëmbëve, ndërsa sytë e picërruar të djalit ishin ngjitur te sytë e tij dhe dukeshin se donin ta përpinin. Buzëqeshja e priftit si dritë e bekuar i mbushte shpirtin. Pasi e vështroi një hop ashtu djalin, i hoqi pëllëmbët nga faqet e njomëta dhe i vuri kryqëzuar mbi gjoks.

- Të mora në krahë dhe m'u duke një pendë, një pendë që dridhej në duart e mia pa frymë, pa gjak, por ende me shpirtin që i regëtinte. Të futa në makinë, në ndenjësen e pasme, të hodha sipër xhupin, të kalova rripin e sigurimit nëpër belin e hajthshëm, të mos më rrëzoheshe tatëpjetës dhe u nisa drejt shtëpisë së doktor Spiros. Fati ynë që e zumë pa dalë nga shtëpia! Nëse nuk e gjenim atë çast nuk

dihej si do të vinte halli yt. Në spitalin e shtetit nuk mund të të çoja, do të kishim shumë telashe. Do të pyesnin kush është, nga vjen, si qe puna...; do të merreshin autoritetet me ty, do të ndaheshim ndoshta pa e njohur njëri-tjetrin e pa ditur asgjë për fatin tënd të mëpasmë.

Djali e vështroi mallëngjyjes. Me mirënjohje në sytë e smeraldtë nën vetullat e holla e qepallat e gjata, në ballin e vogël dhe të lëmuar me tufën e flokëve të gështenj të si kaçube tha: mos o Zot! Dhe bëri kryqin me të shpejtë, sikur koha e miratimit nga ai lart të qe në limit. Prifti shkoi e u ul në kolltukun e tij. U rehatua si ngaherë, duke shtrirë krahët në mbajtëset anësore dhe vazhdoi ligjërimin entuziast.

- Po si mund ta bëja dysh fjalën e Perëndisë?! Si mund të mos e çoja në vend urdhrin e të madhit Zot, që këtë rob të tij në zgrip të humnerës, të cilin ma solli, ja, mu këtu, në pragun e shenjtë të kishës, ta lija në duar të pasigurta, të gremisej e të humbte honeve, e ta rrëmbenin korbat e pashpirt.

- Shpëtoje! - i thashë doktor Spiros dhe të lëshova në duart e tij. Ai vërejti lekat e tua të pista, shtrembëroi hundët nga kutërbimi i djersës dhe më pa i çuditur. Unë e shikoja me ngulm në sy, pa folur, për t'i dhënë të kuptonte se ishte urdhër i prerë: "Bëje!". Doktor Spiroja vështroi edhe njëherë trupin tënd, që i dridhej ndër duar me kokën e varur si zog i ngordhur. Mblodhi vetullat në mes të ballit dhe, me një shprehje habitore në fytyrë, m'u drejtua i pakënaqur:

- *Alvanos?!*

- Njeri! - iu përgjigja.

Tundi kokën në shenjë mohimi, ndërsa mua m'u ngritën kacabunjtë.

- Shpëtoje! - bërtita. - Është rob i Perëndisë!

Doktori u tremb nga ajo këlthitje. Shtroi i qetësuar lëkurën e zhubravitur të fytyrës dhe nuk e zgjati. Tha: *ne, ne*, dhe me ty ndër duar u drejtua në dhomën e poshtme të shtëpisë, atje ku bënte ndonjëherë vizita për banorët e fshatit. Unë i rashë pas.

- Doktor Spiroja nuk i do shqiptarët? - pyeti djali me një sëmbim që i doli përmes vajtimit të fjalëve, duke ia prerë në mes ligjërimin papu Kostës.

- Doktor Spiroja është miku im më i ngushtë, është intelektual dhe besimtar i përkryer, - iu shmang pyetjes prifti. - Nuk mund të mos më bindej, jemi bukë e vjetër.

Djali desh të pyeste përsëri pse doktor Spiroja i ka inat shqiptarët, por e kuptoi që ajo pyetje nuk duhej bërë. Dhe e mbyti sëmbimin brenda vetes. E la priftin ta çonte deri në fund rrëfimin. Dhe ai vazhdoi sikur të mos e kishte dëgjuar pyetjen.

- Ditën tjetër në mëngjes, kur sapo kishte rënë dielli dhe zogjtë këndonin përreth si në një festë, e degët e pemëve harboheshin nga një erë e lehtë që vinte nga gryka e sipërme dhe vraponte drejt luginës, erdha në dhomën tënde. Ishe çelur në fytyrë, ndonëse ende i ndrojtur, i hutuar. Bëre të çoheshe nga shtrati, por unë të vura dorën në sup dhe të thashë: Mos, mos biri im! Edhe shtrati është një lloj ilaçi për të sëmurin. Por ti u ngrite, largove mbulesën në cep të krevatit dhe ndenje me

këmbët varur në dysHEME. Kishe pamjen e një kaprolli të çoroditur në një pyll të panjohur. Dhe ishe i pashëm, i bukur si pëllumb. Faqet kishin marrë ngjyrën e trëndafilut, flokët e rregulluar e të krehur të jepnin kaq nur, sytë qenë gjallëruar dhe balli të fekste si diell mëngjesi. Ishe bërë njeri, biri im, ishe bërë njeri! Ohoooo, sa i bukur dukesh pas asaj që hoqe! Unë t'u ula pranë dhe nuk i gëzohesha dot ringjalljes tënde, jetës tënde të re. Se ashtu më dukej, si një jetë e re për ty. Ti vështroje me sytë e pafajshëm prej fëmije herë mua, herë sendet rreth e rrotull, herë dhomën në të gjitha anët. Vështroje nga dritarja ditën e re plot gjallëri e shpresë dhe nuk flisje. Ishe si i zbritur natën nga një planet tjetër këtu tek unë, te shtëpia e Perëndisë. Ndaj ishe kaq i hutuar atë mëngjes. E mban mend, biri im?

Prifti i rrinte përballë, buzagaz. Jashtë, në degën e një peme nisi këngën një bilbil. Djali doli nga përumbja, pa nga dritarja. Në kuadrat hynte natyra e gjelbëruar, plot diell. Kënga e bilbilit i jepte gazmend të ri.

- Po, papu, - tha, - si nuk e mbaj mend! Vërtet isha i hutuar ngaqë ende nuk e dija ç'do të bëhej me mua. Por edhe nga tërë ai kujdes, mëshirim, dashuri ndaj meje. Isha i trallisur nga gjithë ç'pata kaluar. Dhe nuk gjeja shpjegim për këto përkujdesje. Përse i bëjnë gjithë këto, thosha me vete. Ndieja ngazëllim, por edhe frikë. Nuk e di pse. Frika nuk më linte të gëzoja plotësisht për shpëtimin, për fatin që Zoti më solli te kjo portë e shenjtë. Por, nuk dija as gjuhën që të mundja të shpjegohesha mirë, ndaj ndihesha vërtet në planet tjetër, ndaj isha i hutuar, ndaj nuk flisja. Pastaj më pyetët për emrin.

- Agim, - u përgjigja krenar, i sigurt që emri im nuk do të sillte ndonjë bezdi. Kisha dëgjuar se grekët nuk i kanë qejf emrat myslimanë dhe mendova se isha me fat që emri im nuk ishte i padëshirueshëm. Por vura re se nuk ju pëlqeu. E pashë si ulët kokën, si nxorët një psherëtimë të lehtë dhe si fërkuat mjekrën me dorën e djathtë, duke fshehur pezmin.

- Ç' do të thotë ky emër? - pyetët me zë të fikur.

Unë ngrita supet fillimisht, s' dija si t' jua shpjegoja. Pastaj pashë nga dritarja ditën e mbushur plot diell dhe thashë nxituar: mëngjes do të thotë! Ditë, ja si tani! Ndieja njëfarë gëzimi që munda të gjej diçka për të bërë shpjegimin.

Nënqeshët duke tundur lehtë kokën, dhe mjekra erdhi dy-tri herë majtas e djathtas, dhe kamillafi u tund dy-tri herë si një kabanë e pazëshme. E kuptova që nuk ju pëlqeu emri, të cilin ma kishte vënë kujdestarja e shtëpisë së fëmijës. Kur isha rritur mjaftueshëm sa për të kuptuar e diskutuar ca gjëra, ajo më tha se ky emër ishte simbolik. Thoshte se emri Agim simbolizonte lirinë, jetën e re, shoqërinë e re të një shteti të fuqishëm socialist si i yni. Ajo ndihej krenare për emrin tim dhe kërkonte që edhe unë të krenohesha me simbolikën kaq të madhe të tij. Dhe vërtet krenohesha atëherë. Shpesh, kur dëgjoja emra të vjetër, që më ngjanin si të mbuluar me myk e ndryshk shekullor, ndieja shkëlqimin e emrit tim përmbi ta. Po kaq krenar e thashë emrin tim atë mëngjes, i sigurt se nuk do ta humbte shkëlqimin. Por, ju nënqeshët paksa, fërkuat mjekrën me dorën e djathtë, për të fshehur pezmin. Atë

pezëm që më ngriu gjithë ngazëllimin e mirësive dhe ma zvodhi dashurinë e dikurshme të emrit.

- Emër ateistësh, - thatë duke më parë drejt në sy.

Unë nuk fola. Nuk e kisha gjykuar asnjëherë emrin tim të tillë. E mendoja si idealist, ashtu si dhe ma shpjegonte kujdestarja e shtëpisë së fëmijës, një ëndërr të madhe, të bukur, si agimi kur nis e zbardh dita e zgjohen shpresat, por si emër ateistësh nuk e kisha gjykuar kurrë. Po e dëgjoja atë çast nga goja e një prifti dhe arsyetoja se edhe ashtu mund të ishte, përderisa atëherë e mohuan fenë, përderisa u prishën kisha e xhami, përderisa përherë na thoshin se feja është opium për popujt, fjalë që shumë nga ne nuk ia dinin kuptimin. As unë nuk e dija kuptimin e fjalës opium. E pyeta për këtë një ditë mësuesen e historisë. Po na shpjegonte rolin regresiv, - këtë fjalë e mbaj mend shumë mirë, sepse e përsëritja me mend gjithë ditën që ta fiksoja, ngaqë më dukej si fjalë e madhe prej njerëzish të zgjuar, - pra, kur po na shpjegonte për rolin regresiv të fesë në shoqëri, unë e pyeta ç'është opiumi.

- Helm, - tha duke më zgjatur turizhën mu pranë times, - feja është helm që helmon mendjen e njerëzve, që borgjezia dhe kapitalizmi t'i sundojnë më mirë, - e sqaroi pyetjen me një ndjenjë triumfi.

Atëherë nuk më bëri shumë përshtypje, sepse askush nga ne nuk e dinte vërtet ç'ishte as feja, as kapitalizmi. Mirëpo atë ditë kur emrin tim e quajtët emër ateistësh, u tremba. M'u duk gabim i madh që kisha harruar këshillën e Niko Kapos teksa pushonim te livadhi pranë çezmës me sylynjarin që rridhte sikur zihej raki. Nëmja veten pse

dreqin e kisha nënvleftësuar këtë këshillë?! Pse dreqin nuk thashë që emri im ishte Kristo dhe jo Agim? U ndjeva ligisht nga ajo përveshje buzësh e nuk fola, veç ju shihja në sy. Por ky çast më kujtoi porosinë tjetër të Kapos; atë që të thosha se prindërit m'i kishin vlarë dhe se isha jetim. Kështu, më thanë, do të të marrin me sy të mirë. Nuk e mendova se bëja ndonjë mëkat të madh atëherë. Madje nuk e mendova fare se bëja mëkat. Në fund të fundit, unë isha jetim, ç'rëndësi kishte si dhe pse? Kjo nuk ndryshonte gjë. Kështu e mendova dhe vendosa ta quaja veten një jetim që i ka humbur prindërit në një fatkeqësi. Të paktën mund të largoja përbuzjen, që shpesh e kisha ndier tek më thoshin kopil, sapo merrnin vesh që isha i jetimores. Kjo më dhembte dhe më therte mu në zemër, ngase nuk e ndieja veten fajtor për një gjë të tillë. Kështu që, prej atij çasti të sikletshëm e në vazhdim, vendosa të zbatoja porositë e tjera të Niko Kapos.

Ju thatë “emër ateistësh”, dhe si e patë që unë mbeta ligisht, pa mundur të them gjë, vazhduat: “Nuk është faji yt, biri im, nuk është faji yt. Ti je një viktimë ideologjike. Ç'mund të bëje në atë shtet të pafe?! Të kanë ushqyer qysh në ditën e parë të lindjes me utopi. Ky emër është vetë një utopi, ndonëse simbolikën e ka të madhe, të bukur. Agim! Hë! Agim! Por agimin, ashtu si mbrëmjen, si natën, si ditën, si ditët, javët, muajt, si gjithçka që ekziston dhe që ndodh e ka krijuar Zoti, janë vepra e lavdishme e Tij. Të kanë quajtur Agim, domethënë dritë, ata që të kanë hequr dritën e Perëndisë nga shpirti. Por, drita e Perëndisë është dritë e amshuar dhe nuk mund t'i nënshtrohet tjetër drite,

sepse çdo dritë tjetër është e rreme krahas saj, është e mjerë, e vakët, ngaqë është dritë që vjen prej dritës së Perëndisë”.

Pas këtyre fjalëve nëma përsëri veten që pata harruar këshillën e Niko Kapos për të mbajtur emrin Kristo, jo Agim. Pra Kristo, si Jesu Krishti. Që grekët të mendonin se isha një i krishterë dhe të më merrnin me sy të mirë. Të më merrnin me sy të mirë dhe të mos hiqja siklet, duke u vënë me shpatulla pas muri. Më lodhte llafollogjia e pafund për utopinë dhe për dritën e amshueshme të Perëndisë edhe pse kisha filluar ta ndieja veten të sigurt në shtëpinë e Zotit. Dhe kisha merak se mos mendonit keq e më dorëzonit në duart e policisë, në zyrat e shtetit, a kushedi ku?! Këto mendoja edhe pse fytyra juaj nuk shfaqte ndonjë shenjë mërzie ose pendimi. Rrinit mendueshëm duke më vështruar me njëfarë keqardhje, sikur donit të më thoshit: “Ah, o i mjerë, sa bukur qenkan tallur me ty!”. Fërkonit mjekrën me gishtat e bardhë e të tultë e unë mendoja: “Ndoshta nuk di çfarë të bëjë me mua”. Dhe nuk ia ndaja vështrimin portretit tuaj të menduar. “Ndoshta mendon se i kam mbetur si dopio gjashtë në dorë”, thosha me vete. “Ose i vjen keq që mund të jetë i detyruar të më dorëzojë në shtet e, pastaj, hajde merre vesh ç’ mund të ngjasë; do të më kthejnë mbrapsht, do të më futin në burg, a çfarë? Mbase mendon të më çojë në ndonjë familje të mirë, të punoj dhe të banoj atje, siç kisha dëgjuar për shumë të tjerë. Ose, për të mos pasur telashe, por edhe që të mos e brejë ndërgjegjia, do të më lëshojë natën, ashtu si erdha, të iki nga sytë këmbët, sikur nuk kam qenë kurrë?”



Kështu mendoja. Varianti për ikjen nga sytë këmbët më trishtoi shumë. U mblodha sikur të më kishte plasur rrufeja mbi kokë. Të zbuarit si qen rrugësh e quaja gjënë më të keqe, jo vetëm për shpërfilljen dhe përbuzjen, por edhe sepse, nëse kjo ndodhte, do ndiehesha i braktisur si mes një shkretëtire pa fund e pa anë, pa asnjë pikë orientimi. Ku mund të shkoja i vetëm pa asnjë ndihmë?

Më kishin turbulluar këto mendime, por zëri juaj bariton m'i preu si me shpatë të madhe. Folët me qetësi, por mëshirueshëm. Më thatë: “Gjithsesi, do të rrish këtu, biri im, sa të marrësh veten, pastaj shohim e bëjmë”. Vendosët paqen në zemrën time në atë çast. M'u larguan rrjetat e mendimeve të këqija, të cilat po më pushtonin të tërin dhe sikur u spërndrita me një hir ngazëllimi. Mora frymë i lehtësuar.

U ndjeva fajtor që kisha menduar më kot gjithë ato gjëra të mbrapshta.

Ju ishit aq njerëzor edhe pse emri im ju pati mërzitur. Po, po! Pavarësisht se u sollët mirë me mua, dukej sheshit që emri Agim ju pati mërzitur. Dhe vendosa të isha i vëmendshëm e të mos harroja këshillat e Niko Kapos, nëse doja të mos ndiehesha sërish në siklet dhe të mos ju mërzitja më. Ai më kishte porositur se ishte mirë të mos ju thosha që jam një jetim ose si na thërrisnin shpesh në Tiranë ata jashtë kangjellave të shtëpisë së fëmijës, kopil. Duhet të të shohin me tjetër sy, me atë që u vjen për shtat atyre; të jesh prej njerëzve që nuk e kanë dashur pushtetin e atjeshëm, regjimin, siç i thonë tani. Niko Kapoja më pati thënë gjatë rrugës se grekut është mirë t'i hiqesh si

i përndjekur, ose i persekutuar i regjimit, sepse e quanin shtypës të të drejtave të njeriut dhe antife. Këta njerëz i preferojnë më shumë, thoshte, ndaj bën mirë të mos u tregosh që të ka rritur partia, se do të thonë: edhe kopil, edhe i pafe, edhe komunist. Dhe qeshte me cinizëm.

Për të gjitha këto vendosa atëherë të mos ua rrëfeja të vërtetën. Thashë se prindërit kishin vdekur ditën kur ra zjarri në ish-repartin e ushtrisë, ku ne kishim ngritur me mundim strehëzën tonë, pas nxjerrjes prej shtëpisë së parë nga ish-pronarët.

Pashë si Vasili tundi kokën lehtë prej dëshpërimit, ndërsa ju nxorët një psherëtimë dhe krehët mërzitshëm dy-tri herë mjekrën me gishta. Pastaj folët trishtueshëm.

- Më vjen keq, bir, për ç'të ka ngjarë! Le të shpresojmë të kenë shkuar në parajsë shpirtat e tyre dhe Zoti t'i ketë nën mëshirën e vet! Amin!

Pastaj bëtë kryqin. Bëri kryqin edhe Vasili duke belbëzuar një amin të përvuajtshëm. Ju vazhduat ligjërimin: “Por, falë vullnetit të Perëndisë tani je shëndoshë e mirë. Po me vullnetin e saj je këtu, në shtëpinë e Zotit dhe kjo është një shenjë e mëshirës së Perëndisë ndaj teje, duke të sjellë në duar të sigurta. Le t'i lutemi, pra, Zotit, që të shpëtoi nga e keqja, të të ketë nën kujdesin e Tij dhe të bëjë për ty më të mirën!”.

Vasili tha përsëri amin, me zë më të plotë këtë herë dhe përsëri bëri kryqin. Unë as dija ç'të thosha, as dija ç'të bëja. Pata dëshirë të bëja kryqin si ju, thjesht në shenjë respekti, por edhe të mos dukesh shpërfillës karshi kujdesit dhe lutjeve tuaja. Por nuk m'u bë të lëvizja as

gishtin e vogël. Një si ngërç më mbërtheu. Nuk e kuptova nëse e vutë re hutimin tim, por nuk thatë gjë. Ndoshta ngaqë e kishit të qartë se kishit të bënit me një ateist.

Pas kësaj, u ngritët dhe, si më hodhët dorën mbi sup, thatë: “Tani, shko të hash drekën! Vasili do të sjellë diçka. Pasdite dalim të shohësh fshatin”.

Pasдите, rrinin në oborin e kishës, nën hijen e vidhit, Kostë Kondi, Vasili dhe djali. Fresku u përkëdhelte trupat, cicërimat e zogjve u bënin shoqëri. Vështronin peizazhin mahnitës; gjelbërim gjithandej. Djali ngopte sytë me viset që as i kishte përfytyruar. Jeta i kishte rrjedhur në hapësira të ngushta, të kufizuara, brenda rregullave të jetimores. Harta e lëvizjeve në të shkuarën shënonte ndonjë ekskursion në Dajt, në ndonjë vend piktoresk dhe në disa muze të qytetit. Ditët më të bukura mbeteshin ekskursioni në Sarandë dhe në kështjellën e Krujës. Kaq pati qenë e gjithë hapësira e lëvizjeve të tij. Gjithherë i komanduar, gjithherë i kontrolluar nga kujdestarët, nga mësuesit. Tani këqyrte nën hijen e vidhit këtë mrekulli si një amazonë e pafund, pranë papu Kostë Kondit, këtij njeriu që i qe bërë Zoti i tij dhe pranë Vasilit me ato tipare aq të fisme. Ishte qindra kilometra larg vendit ku kishte kaluar jetën e thjeshtë, të racionuar, me laps të mprehur mirë. Tashmë nuk ia vlente dyshimi nëse kishte bërë mirë apo keq që e ndërmoi aventurën me aq peripeci, lodhje, ankthe, frikëra e shpresa pafund. Gjithçka ishte e shkuar e, ja ku rrinte, në këtë vend të huaj, në oborin e kësaj

kishe, ulur nën vidhin e freskët. Telashet i kishte hedhur pas krahëve.

Por, ndërsa mendonte këto, ndiente një si boshësi, që nuk ia shpjegonte dot pse-në. Ndoshta ngaqë aventura e arratisë i jepte ndjesinë e daljes jashtë galaktikës dhe e mbushte me një mister. Mendimet u bënë udhë kujtimeve të ditëve të fundit. E nesërmja që vetëm një vegim. Pa e ditur të ardhmen jetonte të tashmen, pa asnjë ide në kokë, pa e pasur veten në dorë në këtë jetë të re me një mijë pikëpyetje. E qetësonte vetëm fakti se i kishte shpëtuar vdekjes dhe se paskësh në botë ende njerëz të mirë, si papu Kosta dhe Vasili.

Prifti fërkonte mjekrën me një lloj kënaqësie, me vështrimin tretur në visoret përreth, sikur i shihte për herë të parë, ashtu sikurse djali. Vasili nuk fliste, shihte dhe ai poshtë luginës.

- Ke ardhur në parajsë, biri im, të ka dashur Zoti! - tha papu Kosta pa e hequr vështrimin nga visoret. Pastaj i mëshoi me shpinë mbështetëses ku rrinte. Vetëkënaqësia dhe autoriteti me të cilat dukej i mbushur thellësisht, të jepnin përshtypjen se ishte sundimtar i atyre trojeve.

Djali tundi kokën në shenjë miratimi, pa folur. Në të vërtetë, po e përjetonte pikërisht si parajsë, larg zhurmës marramendëse të qytetit të tij, larg rrëmujës, pluhurit, kaosit. Ky vend i hidhte në shpirt qetim, zgjonte dëshirën për jetë dhe shpresë. Kështu po e përjetonte, por nuk foli, vetëm tundi lehtë kokën duke buzëqeshur.

- Po, as më thua, biri im, prej cilit vend je? - pyeti papritur prifti dhe sytë përsëri i hodhi mbi Vasilin.

Pas përkthimit të Vasilit me atë shqipen që i ngjante si arbëreshe, u ndje përsëri ngushtë. Nuk e kishte menduar nëse do bënte mirë t'u thoshte se ishte nga Tirana, apo nga Korça. Gjatë rrugës djemtë thoshin se nëse kishe pasaportë të Vorio Epirit, siç i thoshin grekët jugut të Shqipërisë, pra nëse u vërtetoje se ishe nga Korça, Saranda, Himara..., ose nëse ishe vllah, ose çoban siç u thoshin rëndom vllahve, të merrnin me sy të mirë. Pale po të ishe minoritar grek, ishe si grek puro, të mbanin në pëllëmbë të dorës. Për këtë vendosi të zgjidhte Korçën si vendlindje. Zgjodhi Korçën edhe për arsye se andej kaloi rrugëtimi i arratisë. Niko Kapoja kishte thënë se emri Korçë vjen nga greqishtja, që do të thotë vajzë, *koricia* dhe se grekët i kanë me sy të mirë korçarët. Pas asaj që kishte thënë Kapoja mendoi se kjo do të ishte arsyeja pse në këtë qytet u këndojnë kaq shumë serenata vajzave. Kështu vendosi të thoshte se ishte nga Korça, edhe për një arsye të tretë; sepse qytetin e kishte shkelur dhe përjetuar, sido që kalimthi, por dinte të tregonte diçka për të nëse e pyesnin. Ndaj u tha se ishte korçar.

Por, zëri nuk i doli i plotë. Mendoi se do t'ia merrnin si shenjë mashtrimi dobësinë e zërit, ndaj i vështronte me merak të kuptonte përshtypjen e përgjigjes. Nuk donte ta provonte edhe njëherë sikletin që hoqi me emrin. Këshilla e Niko Kapos, për të thënë ato që grekët i kishin më për zemër, i rrinte zgjuar në kokë. Për këtë u tremb nga lëvizja e prerë e syve të priftit, nga Vasili tek ai. Por sytë e priftit morën një dritë të gëzueshme, balli iu rrudh me ca vijëzime të buta. Kjo do të thoshte se nuk do të kishte një siklet të dytë si ai për emrin prej ateistësh.

Kostë Kondi foli diçka në greqisht duke parë nga djali, por fjalët ishin për Vasilin.

-Thotë se është i gëzuar që je prej Korçe, sepse ju jeni raca jonë, - përktheu.

Djali nuk diti ta shpjegojë lidhjen e korçarëve me racën e tyre, sipas priftit, por nuk bëri gabimin ta pyeste si e pse, ndonëse ishte i qartë kryekëput prej ç'kishte mësuar në shkollë e ç'kishte dëgjuar në jetë, se ajo thënie ishte një zero me xhufkë. S'donte të futej qorrsoakëve në debate që nuk mund t'u jepte zgjidhje. Megjithatë, një buzëqeshje idioti, të thatë, ua serviri si mirësjellje.

Pas kësaj, Kostë Kondi u ngrit me një kënaqësi të dukshme në fytyrën e bardhë dhe iu drejtua në gjuhë të tij Vasilit, duke mos e hequr vështrimin nga djali.

- Tani ha të shomë fshatin nga përpara qishës.

Rrethuan djathtas me hap të ngadaltë, kaluan nën kurorën e ca pemëve të tjera hijemëdha, zbritën dy-tri shkallina, para se të binin në oborrin e shtruar me pllaka guri e ndalën pranë murit rrethues, nja shtatëdhjetë centimetra i lartë. Prej aty shpalosej pamja e fshatit, si nga një ballkon natyror; një parajsë e vogël, mbytur në gjelbërim dhe në bardhësi. Në qendër binte në sy sheshi, prej të cilit hapeshin në periferi, me ca dredha të lehta, si kapilarë të grinjtë, rrugët e shtruara me kalldrëm. Shtëpitë ishin dy ose trekatëshe, të gjitha me bojë të bardhë dhe me tjegulla të kuqe; më të vjetrat, tek-tuk, qenë mbuluar me pllaka guri. Ishte mesditë, fshati dukej i zbrazët. Ndonjë makinë ngjitej rrugës me asfalt, e cila mbaronte në të hyrë të fshatit, atje ku niste mbretërimin

kalldrëmi, e humbte diku në ndonjë oborr. Oborret e shtëpive gëlonin nga lule dhe pemë, - shumë lule dhe shumë pemë - aq sa dukej se fshati ishte një kompleks që prodhonte vetëm lule dhe pemë. Iu fiksua si një kartolinë në sy, impresionues dhe joshës. Ishte përballja e parë me mjediset greke. I mahnitur nga qetësia, pastërtia, rregulli i ndërtimeve, nga harmonia e objekteve me veten dhe me natyrën, ndjeu kënaqësi që gjendej aty.

Vasili nisi t'i shpjegonte fshatin; lagjet, rrugët, dyqanet, lokalet... Nuk harroi t'i tregonte edhe shtëpinë e tij, një ndërtesë e vogël dykatëshe në rrugicën e lagjes së sipërme, jo shumë larg kishës. Më pas i shpjegoi viset përreth fshatit.

Mbas gjithë atyre shpjegimeve prifti e pyeti:

- Të pëlqen të rrish këtu?

Vasili përktheu me një buzëqeshje fëmije.

E kishte pritur me padurim këtë pyetje, sepse ç'mund të dëshironte tjetër një i humbur në fund të botës si ai? Ndjeu gjakun t'i lëvizte më shpejt nëpër damarë prej gëzimit. Qe një përjetim sikur po hapeshin dyert e parajsës dhe një fytyrë e paqtë, e dëlirë, e fisme si ajo e Vasilit, e ftonte me ngrohtësi dhe dashuri: Eja, o bir i Perëndisë! Dhe duhej të ishte i marrë t'i thoshe jo kësaj ftese fatlume. Tha "po" dhe fytyrat e tyre ndritën. Ndrtitën dhe sytë e smeraldte të djalit. Një dorë e mbarë, e dhimbsur qe caktuar për të marrë përsipër fatin e tij. Dhe dridhej nga emocioni, nga kënaqësia, nga mbarësia. Tha "po" dhe prifti i rrahu supin; bravo, *pedhi mu*, bravo! Dhe Vasili e përqafoi si një mik të vjetër, të cilin kishte kohë pa e parë.



I foli në shqip: të lumtë bir, të lumtë! Pastaj e ktheu në greqisht: Bravo, *file*, bravo! Djali u lumturua për këtë fat bujar. Tani do të kishte ku të fuste kokën, do të kishte edhe një punë, me siguri, dhe do të jetonte pa kokëçarje. Nuk do të ishte më i vetmuar dhe i braktisur, por në pëllëmbë të Zotit, siç tha njëherë Vasili, e, mbi të gjitha, do të ishte njeri si gjithë të tjerët, me dinjitetin e atij që rron me punën e vet. Të gjitha këto e lumturonin. Prifti, të cilin tani po e shihte si vetë Zotin, i vuri dorën në sup.

- Duhet të pagëzohesh, bir! - i foli greqisht.

Pas përkthimit të Vasilit pati një moment stepjeje. “Duhet të pagëzohesh”, i pati thënë Niko Kapoja ndërsa pushonin te lëndina me çezmën me sylynjarin që rridhte sikur ziejë raki. Dhe po si tani ishte habitur. Fjalët e tyre i kishte marrë me shaka atëherë, tani nuk dinte ç’t’u thoshte paput e Vasilit. Seç kishte një drojë të pashpjeguar të fliste menjëherë. Ideja se pas pagëzimit nuk do të ishte ai që kishte qenë, nuk i shqitej prej çastit kur Nikoja dhe Ilia i thanë se duhej të quhej Kristo, si Jezu Krishti dhe jo Agim, si deri atëherë. Nuk e përfytyronte dot ç’do të ndodhte me Agimin kur të bëhej Kristo. A do të mund të bëhej një besimtar i devotshëm si e donte Zoti? A i kishte Zoti me sy të mirë ateistët që shndërroheshin në besimtarë? A ua falte të kaluarën apo ajo u mbetej në shpinë tërë jetën, si biografia e keqe në kohën e shkuar? Ndruhej të thoshte “po” prej këtij merak. Nuk e dinte nëse do të mund të ishte i denjë në të ardhmen nën lëkurën e besimtarit. Kërkonte në thellësi të ndërgjegjes kurajën për t’i bërë gjërat me bindje dhe besim.

Vorbullat e mendimeve ia preu zëri i priftit. Pastaj Vasili përktheu shpejt.

- Ç' thua për pagëzimin, bir?

Ja kishte zgjatur mu në surrat fytyrën e thatë e të mbuluar me shprehjen e pritjes. Edhe prifti kishte të njëjtën shprehje në fytyrën e rrumbullakët e të tultë.

Nuk kishte kohë të mendohej. Si rrufe i erdhën ndër mend fjalët e Nikos, te lëndina: Këtu të gjithë njerëzit duhet të pagëzohen. Edhe ti duhet të pagëzohesh patjetër, të të marrin me sy të mirë. Ndryshe të shohin vëngër, si qen të zgjebosur. Janë të fiksuar pas fesë. Edhe emrin ndaj të thashë ta ndërrosh, nuk mund të pagëzohesh me këtë emër që ke, Agim.

Kësisoj e dha përgjigjen rrufe. Tha sërish “po”, me ton të prerë. Fytyrat e Paput dhe Vasilit u zhveshën nga pritja, u zbukuruan nga buzëqeshja dhe u ndriçuan nga gëzimi.

## Pjesa e dytë

### 1

Por jo, jo, jo! Nuk mund të ketë dy të njëjta. Me siguri sytë shohin vegime të shkuara, tjetër realitet. Sepse nuk mund të ketë dy në të njëjtën botë, arsyetonte habitshëm. Jo! Mirëpo, vajza - vegim përballë ishte pasqyra e saj. Po ajo fytyrë e ëmbël, po ajo buzëqeshje e dielltë, sytë si det opali blu po ata. Edhe lëkurën bardhoshe si një engjëll, mjekërzën e vogël si prej elfi, mollëzat e faqeve me gropëzat e vockla ku mblidhej gjithë gëzimi i pafre, flokët e verdhë lëshuar pas si ujëvarë e artë, shtati i drejtë, i hajthshëm, lozonjar që përdridhej në çdo hap, veshja elegante me atë kostum të bardhë veror prej cohe linoje, me pamjen e një hyjneshe mitologjike; gjithçka, po si e saj. Po aq magjepsëse si ajo, po aq joshëse. Sa reale, aq ireale; sa e përkryer, po aq admiruese. Ndiante verbimin e bukurisë t'i mësynte syve, mallin t'i zgjohej si vullkan, dëshirën për ta pasur pranë t'i ndizej, etjen për një përqafim t'i rritej përbrenda. Sepse befas që shfaqur dritëza e largët që e kishte mbajtur të fshehur në zemër

si ndoca gaca të zjarrta nën hirin e një vatre, një grusht ngrohtësi në akullsinë e skajshme të jetës së vobektë, sa për të mos harruar ç'është dashuria, ajo që e shkundte ndonjëherë nga mjerimet e jetës, për t'i treguar se, ndoshta, edhe ia vlen të jetohet. Dhe ja, ku feksi mu përpara tij, si një vetëtimë tej e tej qiellit kjo dritëz e kahershme, që u përhit papritur. Hutimi që i beftë, çoroditja e plotë, habia e frikshme, si të luaje më ëndrrën më të bukur.

Prifti dhe Vasili panë nga djali, por ai nuk shihte gjë tjetër, veç atij burimi drite ngjyrë ylberi përballë. Ishte ngurosur si me magji. Këmbët nuk i bindeshin për të bërë përpara si fëmijët e tjerë që shoqëronin papun në ceremoninë e Pashkës së Madhe. Qiriri në dorën e djathtë nuk qëndronte më vertikalisht; qe rrëzuar anash bashkë me dorën e pavullnetshme. Flaka regëtinte duke iu kacavjerrë mundimshëm trupit të dylltë, pothuajse kokëposhtë. Fëmijët krah tij kaluan njëri pas tjetrit, ndërsa ata pas mbetën të bllokuar, ngaqë ai nuk po dilte dot nga gjendja e ngërçit. Dikush e shtynte me duart në shpinë, po ai vetëm hidhte ndonjë çap si pa dashje dhe ngecte sërish. Përhubnja e gjithëpushtetshme e kishte paralizuar. Donte të besonte se ajo dritë ngjyrë ylber nuk ishte vegim. Vajza përballë buzëqeshte me çapkënllek e dëlirësi, si dikur, veçse nuk e kishte fare mendjen tek ai. I gëzohej asaj dite feste, i lumturohej pa pra freskisë dhe hireve të moshës, bukurisë së vet fluturake, për të cilën, me sa dukej, ishte e vetëdijshme si të qe e bekuar prej zotash. Lazdrohej ajo qenie prej ëndrre për krah gruas, po me hire të bukura, të ruajtura ende me fanatizëm dhe me

përkushtim. Në krahun tjetër edhe burri i zeshkët, i gjatë dhe trupdrejtë si një atlet, me kostum ngjyrë mjalti, këpucë në kafe të modës së fundit, këmishë të bardhë e kravatë në karnelian, i gëzohej gëzimit të vajzës që llastohej me lëvizje dhe fjalë pa fund. Të tre ishin rrethuar nga një qiell lumturie, duke lënë gjithë botën tjetër mënjanë. Ndiqnin plot ngazëllim ceremoninë në rreshtin e parë të besimtarëve.

- Kristos! Kristos! Lëviz djalë, pse hutohesh? - i foli nën zë Vasili, duke i shkuar pranë.

Djali sërish nuk dëgjoi, rrinte pa lëvizur. Nga mbrapa shpinës filluan pëshpërimat. Pastaj, e shtynë pak më fort, duke i shfryrë te veshi: *volta alvaniki*. U çapit si një robot, po sytë nuk i shqiste prej vajzës. Pranë saj, fare pranë saj, vetëm një pëllëmbë larg, i ngriu sërish hapat, sytë i nguli në ata të vajzës, në ato dete opali shkëlqimtarë që xixëllinin nga hareja buisëse. Çiltërsia fëminore i jepte karatët e fundit atij xhevahiri që lëbyrte sytë e njerëzve. Ashtu si atë ditë, kur mbështetur në banakun e sportelit të bibliotekës së qytetit, në pritje të librit të porositur, ajo u shfaq te dera me buzëqeshjen që i pati mbetur ende, kushedi pse, prej së jashtmi godinës, në fytyrën e njomë e të bukur si prej engjëlli. Ecte lozonjare, haplehtë, sikur vallëzonte, pa asnjë drojë, pa asnjë siklet nga të pranishmit, të cilët i shpërfilli me vetësigurinë dhe krenarinë. U ngul drejt e te banaku, përkrah tij, duke i buzëqeshur si të njiheshin prej kohësh. Të tjerët pëshpëritën diçka, nxorën ndonjë belbëzim, panë njëri-tjetrin me habi dhe heshtën. Prisinin minuta të tëra në

radhë dhe ja, një vogëlushe i shpërfillte kaq lehtësisht dhe paqësisht.

Sportelistja ndodhej në brendësi, për të marrë librat e porositur, kësisoj, nuk pati kujt t'i drejtohej. Me një lëvizje të prerë u kthye nga ai. Një aromë parfumi dehës ia ngopi hundët paq djalit. Pa dy sy opali që rrëzëllenin thellësisht, një fytyrë përsosmërisht të bukur dhe ca flokë ngjyrë ari, që u valëvitën lezetshëm pas lëvizjes së menjëhershme të kokës. Kur pa portretin e tij, ajo buzagazi dëlirësisht: Ohoo, bjondo ti, e bjonde unë! Dhe qeshi aq bukur! Pastaj shtoi: Edhe sytë i paske blu, si unë. Dhe përsëri qeshi bukur. Fliste llastuar, me lëvizje të trupit si ndonjë balerinë kukull, e cila i ka lëvizjet të njëtrajtshme, të programuara sipas kurdisjes dhe as që i bëhej vonë se holli ishte i mbushur plot me njerëz, prej të gjitha moshave. Jehonat e së qeshurës së saj mbushën hapësirën. Dikush i tërhoqi vërejte për qetësinë e prishur, por ajo përveshi buzët e tulta shpërfillëse, për të thënë “hë se nuk u bë hataja”. Pastaj vuri gishtin tregues para buzëve, lëshoi një shëëët, si fëmijë kopshti, e sërish ia dha të qeshurës nën zë, duke i dhënë fytyrës gazmend të rrallë dhe bukuri edhe më të rrallë.

Ai nuk fliste. E vështronte me habi, por edhe me kënaqësi të madhe që i rrinte kaq pranë, që i ndiente aromën si prej pranvere, që i shihte sytë e gëzuar si dete opali, që i kundronte fytyrën e bardhë si prej alabastri dhe që i shijonte të qeshurën e padjallëzuar. Por, mbi të gjitha këto, ndiente kënaqësi akoma më të plotë, që në gjithë atë mori njerëzish, ajo po i drejtohej vetëm atij me lirshmërinë e një të njohuri të vjetër. I hutuar krejt nga

kjo skenë, qëndronte pa folur. Nuk e kishte parë kurrë atë vajzë.

Ajo i shpupuriti flokët e artë si kaçube.

- Bjondo, - i tha buzagaz, - nuk mërzhitesh! - dhe bëri me kokë nga sporteli, duke nënkuptuar t'i lëshonte radhën, por ai qe bërë gur nga prania e saj e nuk bëri asnjë veprim.

Ndërkohë, hyri sportelistja me disa libra në duar. I lëshoi mbi banak e thirri emrin e tij. Të dy panë atë, ndërsa ajo shtangu duke vështruar të rinjtë pranë e pranë.

- Motër e vëlla?! - pyeti, e sigurt se ia kishte qëlluar. - Ç'bjondushë të bukur! Edhe syçkat blu si deti të dy!

Vajza përveshi buzët duke u lazduar, përdrodi trupin e hajthshëm e të drejtë e tha me një kukurisje që kumboi nëpër ajrin e heshtur të sallonit:

- Ha-ha-ha, vëllaçkoja im, - dhe i shpupuriti përsëri flokët. - Kam vëllaçko të bukur, - iu drejtua sportelistes, e cila harroi të bënte punën e vet, vështronte ata të dy pa kuptuar mirë skenën.

Edhe të tjerët rreth e rrotull nuk po kuptonin asgjë, ndaj nuk flisnin. Sportelistja nuk e zgjati, i dha librin djalit, por vajza ia rrëmbeu prej duarsh. I hodhi një sy titullit mbi kopertinë.

- Shpella e piratëve. Ah, vëllaçko, sa i urrej piratët! - shtoi me përdredhje llastice. Fliste pa e vrarë mendjen për gjindjen. Qe kaq e natyrshme në llastimin e saj, sa ishte e pamundur ta merrje inat.

I humbur në hutimin e vet, ai mënjanoi pak kokën me kaçubën ngjyrë ari, vuri buzën në gaz e bëri të thoshte

diçka, por vajza me shkathtësi iu drejtua sportelistes, pa e lënë të nxirrte zë.

- Unë dua “Fantazma dhe plani tre plus katër”, të lutem!

Pastaj u kthye nga ai.

- Fantazmat më pëlqejnë më shumë se piratët. - foli edhe njëherë lazdrueshëm.

- Pa shih, me Petro Markon të dy, - tha punonjësja e bibliotekës e i tregoi me sy njerëzit që prisnin pas saj, të cilëve duhej t’u merrte miratimin. Vajza u rrotullua shpejt si një fugë, u dhuroi një buzëqeshje të ëmbël plot domethënie, tamam si një zonjushë e vërtetë. Priste e bindur pohimin e tyre. Dhe ashtu ndodhi. Nuk foli kush, por pohuan me kokë e me gjeste të tjera atë që kërkonte vajza.

Pas disa minutash të dy adoleshentët gjendeshin në shkallët e bibliotekës, secili me librin e vet në dorë. Ajo me gëzimin e përhershëm ndër sy, ai me hutimin e lumtur. Ajo i shpupuriste flokët, ai e vështronte dhe nuk fliste. Gjuha i qe lidhur, mendimet i qenë syrgjynosur, zemra i rrihte sikur godiste me tokmak. Një valë e pashpjegueshme i mbushte kraharorin, gati sa nuk i merrte frymën. Ç’që kjo ditë kështu, kjo mrekulli e rënë prej qielli?! Nuk kishte biseduar kurrë kështu me një vajzë (në të vërtetë as që po fliste fare). Kurrë një bukuri nuk e kishte përjetuar kështu! Asnjë vajzë nuk ia kishte shpupuritur aq ngrohtësisht me duart e njoma flokët si kaçubë, sa t’i bënte mishin kokërr! Asnjë nuk i kishte qëndruar pranë me një kundërmim kaq marramendës!



- Hej, vëllaçko, - e shkundi sërish nga përhumbla vajza, - e kemi në një ditë dorëzimin e librit, do të takohemi përsëri.

Ai pohoi me kokë, duke u përqendruar në sytë blu, sikur donte t'i përshkonte thellë edhe më thellë, atje ku buronte ajo dritë e magjishme. Por një zë burri u dëgjua, i prerë dhe autoritar, si një ushtarak.

-Teuta, shpejt! Shoferi po pret në mes të rrugës, duhet të jem në zyrë sa më parë.

Krah tij qëndronte një zonjë e bukur, e rregulluar më së miri, stolitur po aq mirë me bizhu të shtrenjta, me fustan në ngjyrë rozë, me ca lule shpatarakësh të verdhë e me një kollan të bardhë në mes, mbi një palë këpucë gjithashtu të bardha me majuc. Nuk fliste. Fytyra simpatike i qe veshur me çehre të vranët. Vështronte rreptë ata të dy. Herë njërin, herë tjetrin, sikur kërkonte të gjente ndryshimin. Edhe burri nuk fliste. I hodhi sytë, ashtu si gruaja, sa te njëri te tjetri, si të mos dallonte dot vajzën nga djali. Pastaj, burri dhe gruaja u vështruan ndër sy. Një tension i fshehur u lëvrinte nën lëkurë. Vajza ende buzëqeshte, ndërsa ai u përmyt nga hutimi, tani prej përballjes sy më sy me çiftin. Burri bëri një hap para me dorën e zgjatur drejt vajzës.

- Shkojmë, - tha.

Vështroi shkarazi djalin. Gruaja i ndiqte me sy vigjilentë, pa lëvizur nga vendi. Vajza i shpupuriti edhe njëherë flokët, i tha buzagaz: Pafshim vëllaçko!

Burri e pa çuditshëm vajzën, po ajo as që e vuri re. Nxitoi të lidhej dorë për dorë me të. Gruaja vështronte ngultas djaloshin, rreptë, me një tis të akullt në fytyrë. E

zhbiroi mirë e mirë nga koka në këmbë me sytë dinakë, kapi edhe ajo për dore vajzën, u kthye rrëmbimthi dhe turfulloi nën zë: As mos e shko nëpër mend!

I kthyen shpinat të tre dhe e lanë aty mbështjellë me hutim dhe habi.

- Or çun, lëviz vendit, - i pati folur dikush që po dilte atëherë nga biblioteka, pasi ky qe gozhduar te porta e nuk kishte ndër mend të hidhte një hap. E gjitha ç'kishte ndodhur i dukej një ëndërr...

- Lëviz, or çun, lëviz, shko pas të tjerëve, - dëgjoji t'i flisnin tani në greqisht. Por, edhe tani, i gozhduar para vajzës, nuk i bëhej të hidhte asnjë hap. E vështronte ngultas, duke e përpirë me sy. Ja, ndoshta tani do t'i kujtohet vëllaçkoja, do të gazmendet, do të qeshë me të madhe, bukur, ashtu siç di ajo. Kubeja e kishës do mbushet me zërin e saj kumbues si jehonë kambanash për krishtlindje. E do të thotë: "Vëllaçko, po ti këtu? Oh, si na bashkon Zoti!". Dhe pastaj do t'i shpupuritë flokët, dikur kaçube, tani të qethur shkurt, të krehur bukur, të lyer me xhelatinë, si për ditë të shënuar. Do të ndiente përsëri atë valë të nxehtë në kraharor që ia shpërthente mushkëritë sa s'merrte më frymë. Do ta përkëdhelte në kokë dora e saj e vogël, e brishtë, e butë si dora e vetë hyjneshtë Afërditë. Dhe, o Zot, nuk ishte ëndërr! As vegim nuk ishte. Po ndiente dorën e saj t'i shpupuriste flokët e qethur, i ndiente mollëzat e buta të gishtave ta ledhatonin, drithërimat e lumturisë t'i shkonin mu në zemër. Buzëqeshi i ngazëllyer, i hutuar, i pafjalë, me

shikim të ngulur si i marrë te sytë si dete opali që po e përmblytnin me buzagazin shpresëdhënës.

- Çuno, u hutove! Ah, i shkreti ti!

Ishte zëri i saj, ishte ajo. Po aq shpërfillëse dhe moskokëçarëse si atë ditë në bibliotekë. E qeshura shpotitëse kumboi mbyturazi dhe u shua në veshët e tij.

- Ec, çuno, ec, se bëre rrëmujë, - kumboi sërish zëri shpotitës, duke i hedhur tani në shpirt zhgënjimin e dëbortë. Vajza e zuri për supi, e rrotulloi në drejtimin e duhur si të ishte një lodër, andej nga vazhdonin të ecnin fëmijët e tjerë që kryenin ceremoninë.

Ndërkohë, çifti i dikurshëm qëndronte pranë vajzës. Buzëqeshnin me çapkënllekun e saj. Burri e shihte me një farë dyshimi, sikur t'i kujtonte diçka të largët, ndërsa gruaja e kishte shigjetuar me vështrim përçmues. Disa mëmërima ndjeu nga pas dhe zërin e Vasilit që e nxiste: Mos u huto, Kristos, ec, bir, ec! Më pas, një e folur me zë të ulët i pëshpëriti greqisht te veshi: "Ksipna, alvane, ftani na qimase"<sup>1</sup>. Dy duar iu mbështetën në shpinë dhe i dhanë një të shtyrë. Këmbët dolën nga ngërçi, hodhën ca hapa të ngathët fillimisht, si të ishin gjymtyrë të ndryshkura, por koka mbeti mënjanë, andej nga qe portreti i vajzës, e cila qeshte dhe argëtohej fëmijërisht me hutimin e tij. Përhëndeste duke tundur dorën në ajër, por atij i theri në zemër ajo përhëndetje si një lamtumirë. Me hidhërim e hoqi vështrimin andej dhe u fut në ritmin normal të ceremonisë, pas papu Kostës, që shkonte drejt altarit

---

<sup>1</sup> Gr. - Zgjohu, shqiptar, mjaft fjete!